



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.07.2014 ora 9:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin komunitar “Creative Europe 2014””
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit të furnizimit me ujë të Peshkopisë “Kontratë me çelësa në dorë”.
4. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Silva Caka dhe Mark Frroku.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Tom Doshi, Arben Ristani, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Gent Strazimiri, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Mhill Fufi dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Elira Kokona – sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës

Jovan Gjika – Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Milbana Treska – drejtore e Borxhit Publik në Ministrinë e Financave

Gentiana Sula – zëvendësministre e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Silvana Banushi – drejtore e Përgjithshme e MMSR-së

Ermira Shtino – drejtore e ish të Përndjekurve Politike

Bilal Kola – kryetar i Institutit të ish të Përndjekurve Politike

Erald Mihali - specialist në Drejtorinë e Pagesave dhe të Dëmshpërblimeve në Ministrinë e Financave

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Të nderuar deputetë, fillojmë mbledhjen. Paradite kemi tri pika.

Pika e parë është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian”. Nga Ministria e Kulturës, që është ministria nismëtare e projektit, është zonja Elira Kokona, sekretare e Përgjithshme.

Mirë se keni ardhur!

Fillimisht do të dëgjojmë një ekspozitë të shkurtër të përmbajtjes së nismës dhe të marrëveshjes. Ministria ka sjellë një memo ku e sqaron në mënyrë të përmbledhur. Dëshiroj të falënderoj zonjën ministre për vëmendjen që ka treguar ndaj komisionit dhe shpresoj se edhe ju do të na bëni një paraqitje të përmbledhur, sepse kolegët kanë në dispozicion marrëveshjen dhe memon e zonjës ministre.

Relator është zoti Peza.

Fjalën e ka zonja Kokona.

Elira Kokona – Faleminderit, zoti kryetar!

Është kënaqësi të jem këtu dhe të paraqesë këtë marrëveshje, pasi është një nga nismat e para që ministria Kumbaro ka marrë sapo mori detyrën. “*Creative Europe*” është një program i Bashkimit Europian për periudhën 2014-2020, me një vlerë të konsiderueshme prej rreth 1,5 bilionë euro, fonde të vëna në dispozicion nga Bashkimi Europian për të gjitha subjekteve, të cilat mund të jenë persona fizikë ose juridikë, privatë ose publikë nga vende të ndryshme anëtare të Bashkimit Europian, por edhe vende kandidate, të cilat mund të aplikojnë drejtpërdrejt në Bashkimin Europian për të përfituar këto fonde.

Në vijim të asaj çfarë ministria Kumbaro i ka dërguar këtij komisioni, desha të tërheq vëmendjen në dy elemente të rëndësishme të kësaj marrëveshjeje. I pari, ka të bëjë me faktin se në janar të vitit 2014, Bashkimi Europian vendosi t’i japë mundësi Shqipërisë, pavarësisht se të gjitha vendet dhe subjektet e tjera e tjera që do të apliknin duhet të ishin anëtarë ose vende kandidate, për përpjekjet që kishte bërë në kuadrin e kulturës dhe më gjerë, që të mund të përfitonte nga këto fonde, pavarësisht faktit nëse e kishte statusin e kandidatit ose jo. Kështu që, në janar mund të themi se kultura arriti të

bënte një hap përpara në lidhje me statusin e vendit kandidat, duke u dhënë mundësinë subjekteve shqiptare, publike dhe private të barazoheshin me të tjerët.

Një element tjetër i rëndësishëm i këtij programi është ngritja e një pike kontakti, e quajtur “Helth desk cerative Europe”. Strukturë e ngritur brenda Ministrisë së Kulturës për të krijuar së bashku me organizmat e tjerë simotra në ministritë e tjera referente të këtij programi, mundësinë e network-ut, i cili do t’i jepte mundësinë subjekteve të ndryshme private ose publike që të mund të aplikonin në Bashkimin European për të përfituar këto fonde. Gjithashtu edhe për të krijuar lidhje me njëri-tjetrin dhe për të përgatitur së bashku këto kërkesa.

Një element i rëndësishëm për t’u përmendur është se Ministria e Kulturës për t’i ardhur në ndihmë këtyre subjekteve filloi të realizonte gati të njëjtin proces thirrjesh edhe për fondet e saj, ku subjektet shqiptare gati përdorin të njëjtën metodologji: atë të mbushjes së një formulari specifik, ku udhëzimet janë të qarta në mënyrën sesi përfitohen fonde publike. Nuk ka rëndësi nëse këto fonde publike janë të buxhetit të shtetit shqiptar apo vijnë nga Bashkimi European. Me këto dy arritje mendoj se Ministria e Kulturës është mundur të krijojë një premisë goxha të mirë për subjektet, për të bërë të mundur që ata të kenë mundësi të aplikojnë.

Në fakt, Shqipëria nuk është për herë të parë pjesëmarrëse e një projekti komunitar. Ajo ka qenë pjesëmarrëse e një projekti komunar të ngjashëm në fushën e kulturës, në përmasa më të vogla, që ishte “Europa për qytetarët”. Subjektet shqiptare private dhe publike kanë pasur mundësi të përfitojnë nga këto fonde, por shpesh atë kanë qenë të lidhura vetëm me botimet dhe përkthimet. Në pjesën e artit dhe të kulturës ka pasur mangësi në mënyrën se si subjektet përfitonin dhe arrin të kërkonin përthithjen e fondeve. Kështu që kjo është arsyeja pse Ministria e Kulturës ka filluar një seri trajnimesh për subjektet që të kenë mundësinë e këtyre përfitimeve.

E fundit, që mendoj se është e rëndësishme, ky projekt ka tri subprograme. Njëri është kultura dhe dy të tjerët kanë të bëjnë me mediat.

Bashkimi European për momentin ka konsideruar se Shqipëria nuk mund të marrë pjesë në dy programet e medias, për faktin se si ligji për median dhe aktet nënligjore nuk janë në përputhje me direktivën përkatëse, deri në një moment të dytë, le të themi. Në çdo rast, Ministria e Kulturës ka parashikuar biletën e hyrjes për të marrë pjesë edhe në dy

programet e tjera. Në buxhetin e saj ekzistojnë këto fonde të parashikuara. Sapo të kemi OK-in nga Bashkimi European, do të marrim pjesë edhe në këto subprograme.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit edhe për zgjerimin që i bëtë përmbajtjes së marrëveshjes dhe kushteve të vëna nga Bashkimi European! Relatori e ka fjalën.

Dashamir Peza – Programi “*Creative Europe*” është një program i Bashkimit European në fushën e kulturës, me një buxhet total prej 1,5 miliardë eurosh dhe i jep mundësinë artistëve, si dhe organizatave publike dhe jopublike shqiptare të bëhen pjesë e projekteve që do të rrisin, qarkullojnë dhe promovojnë produktet e tyre artistike. Institucionet përfituese nga ky program janë Teatri Kombëtar, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Galeria Kombëtare e Arteve, Biblioteka Kombëtare, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, Ansambli Popullor etj. Unë mendoj se nga pikëpamja procedurale, projekti i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, i cili është edhe organi kompetent. Kjo marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, në cilësinë e relatorit, i propozoj Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të drejtave të njeriut miratimin e këtij projektligji dhe kalimin e tij për votim në seancën plenare.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Peza!

Dëgjuam përfaqësuesen e ministrisë në ekspozenë që bëri rreth marrëveshjes dhe relatorin. Kalojmë te pyetjet.

Fjalën e ka zoti Fino.

Bashkim Fino – Një gjë nuk e kam shumë të qartë: komuniteti european ka 1,5 bilionë euro. Ne miratojmë një marrëveshje dhe mirë bëjmë që e miratojmë. Subjektet tona do të aplikojnë mbi bazën e kësaj shume në qoftë se fitojnë pavarësisht shumës që paguajmë ne nga 55 mijë euro çdo vit, vitin e parë e paguani ju si ministri, pastaj vitet e tjera... Domethënë, subjektet tona do të aplikojnë në këtë program dhe në qoftë se fitojnë do të marrin fonde, në qoftë se nuk fitojnë nuk marrin fonde. Kjo është gjithë esenca?

Fatmir Xhafaj – Zonja Kokona, një përgjigje, ju lutem!

Elira Kokona – Po është e vërtetë, Shqipëria do të paguajë vetëm thjesht një biletë hyrjeje, e cila i jep mundësinë subjekteve shqiptare, ashtu si me të drejtë ju e

përmendët, të aplikojnë për fonde. Është shumë e rëndësishme, prandaj unë përmenda faktin se Ministria e Kulturës po bën të pamundurën që të formojë subjektet, në mënyrë që këto subjekte të jenë në gjendje të prezantojnë projekte dhe programe, si dhe kërkesa të sakta dhe të plota.

Është e vërtetë, subjektet edhe mund të mos përfitojnë.

Bashkim Fino – Do ta zbërthej këtë projekt marrëveshje që të votoni edhe ju me ndërgjegje. Sa është pritshmëria juaj, zonja sekretare e Përgjithshme, që nga 1,5 bilionë, që janë fondet e Europës, do të mund të përfitojnë subjektet tona, ato që tha Dashi e të tjera me radhë, nga këto programe dhe kur them sa është pritshmëria juaj, nuk dua t’ju vë përpara përgjegjësisë për të thënë a do i bëjnë rregullat ose programet që të përfitojnë nga Europa apo jo? Normale që do t’i bëjnë, por dua të di një pritshmëri si ministri, pavarësisht fjalëve të mira që ju thatë: do të përfitojmë vërtet apo jo?

Fatmir Xhafaj – Zonja Kokona, besoj se përgjigja juaj do të jetë shteruese, që kolegut tim, zotit Fino, mos t’i jepet mundësia për pyetje tjetër.

Elira Kokona – Pa pasur asnjë lloj përgatitje subjektet shqiptare në vitet në vijim kanë përfituar rreth 170 mijë euro...

Bashkim Fino – Pa përgatitje 170 mijë euro, imagjino të përgatitur...

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord në parim pas kësaj përgjigjeje.

Jeni dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Jeni dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi?

Miratohet.

Faleminderit, zonja Kokona për ekspozenë, për prezencën dhe për përgjigjet e pyetjeve!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.07.2014 ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit të furnizimit me ujë të Peshkopisë “Kontratë me çelësa në dorë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Silva Caka dhe Mark Frroku.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Tom Doshi, Arben Ristani, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Gent Strazimiri, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Mhill Fufi dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Jovan Gjika – Koordinator i projekteve në Ministrinë e Transportit dhe të
Infrastrukturës

Milbana Treska – drejtore e Borxhit Publik në Ministrinë e Financave

Fatmir Xhafaj – Fillojmë shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria AG, për financimin e projektit të furnizimit me ujë të Peshkopisë “Kontratë me çelësa në dorë”.

Të ftuar për këtë projektligj kemi zotin Jovan Gjika nga Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës dhe zonjën Milbana Treska nga Ministria e Financave.

Ju lutem, bëni një ekspozitë të shkurtër të projektit, duke qenë se ne e kemi këtu relacionin dhe përmbajtjen e marrëveshjes!

Jovan Gjika – Në kuadër të këtij financimi synohet të realizohet zëvendësimi dhe rehabilitimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të qytetit të Peshkopisë, si një pjesë integrale e gjithë sistemit. Pjesa e garantimit të prurjes për popullsinë duke përfshirë edhe transmetimin deri në qytet është zgjidhur me investimet e mëparshme. Konkretisht në vitin 2012 ka qenë një financim për ndërtimin e linjës së transmetimit nga një nga burimet që furnizon qytetin, nga UNDP-ja, që ka rritur sasinë e ujit që hyn në qytet, por për arsye të gjendjes së sistemit shpërndarës në qytet, situata është jashtë kushteve teknike dhe kushteve normale të menaxhimit të një sistemi.

Nëpërmjet këtij financimi synohet që në tërësinë e vet të zëvendësohen rreth 33 km rrjet shpërndarës. Gjithashtu të integrohen linjat e reja me sistemin ekzistues, duke bërë testimet teknike gjatë fazës së ndërtimit të rrjetit ekzistues, në mënyrë që në fund të kemi një sistem të plotë të mbyllur, të komanduar automatikisht nëpërmjet sistemit SKADA të kontrollit të niveleve dhe prurjeve për të garantuar një furnizim 24 orë me ujë për qytetarët e qytetit të Peshkopisë. Po ashtu përfshihet edhe sistemi i matjes për çdo konsumator të qytetit. Madje matës të mëdhenj për linjat kryesore të furnizimit, por edhe matës familjarë dhe matës për bizneset, në mënyrë që ta kemi të plotë edhe sistemin e matjes.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Gjika!

Relator është zoti Manja, i cili është edhe deputet i këtij qarku.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit të furnizimit me ujë të Peshkopisë “Kontratë me çelësa në dorë”, në vlerën 4 milionë euro, në aspektin ligjor është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ndërsa në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendi. Për këto arsye ju ftoj ta votojmë dhe t’ia kalojmë seancës plenare për miratim.

Fondi i parashikuar është rreth 4 milionë euro dhe do të financojë në masën 100% kontratën për furnizimin me ujë të qytetit të Peshkopisë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Manja!

Ka pyetje për projektin.

Fjalën e ka zoti Klosi.

Blendi Klosi – Kam një pyetje për ju, jo për përfaqësuesit e ministrisë. Koncepti “kontratë me çelësa në dorë” është koncept juridik?

Fatmir Xhafaj – Po, do të thotë se mbyllet me gjithçka.

Zoti Fino e ka fjalën.

Bashkim Fino – Zoti kryetar,

Kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme, por unë kam dy pyetje shumë më të rëndësishme edhe për kolegun Manja, meqenëse është deputet i qarkut.

E para, ky projekt, me sa kuptova këtu, do 18 muaj të bëhet dhe në relacion thuhet se janë një sërë elementesh që duhen bërë, madje mes tyre do të kemi edhe 3500 matës. Ajo që më intereson mua është që kur bëjmë një investim, të bëjmë një investim europian, meqenëse do të shkojmë në Europë. Kjo do të thotë se duhet të instalohen të gjithë matësit që edhe çështja e kostos ose pagesa nesër të jetë më se korrekte dhe e rregullt për të vepruar si në Europë. Mos të bëjmë investime gjysmake. Thjesht të shtrojmë tuba, të shkojë uji 24 orë dhe të kemi humbje në rrjet, siç kemi në energji, e të mos kemi pagesa.

A e ka marrë përsipër ky projekt realizimin e investimit deri në fund, siç thoni ju, me çelësa në dorë, që në nesër në qytetin e Peshkopisë kur të hapet rubineti, në çdo

moment ndërmarrja përkatëse mund të shkojë te çdo konsumator dhe t'ia ndërpresë ujin, siç mund t'i ndërpresë energjinë elektrike, kur nuk e paguan? Sepse ne bëjmë investime, por dalim përsëri me humbje dhe ribëjmë investime.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Zoti Gjika!

Jovan Gjika – Pikërisht, investimi përfshin deri pikën fundore, që është konsumatori, duke përfshirë edhe instalimin e matësit, pastaj nënshkruajmë kontratat e reja me çdo konsumator. Numri i matësve dhe të dhënat janë rakorduar me ndërmarrjen e Ujësjetës të Peshkopisë, por, pavarësisht kësaj, projekti ka një fazë tremujore të hartimit të projektit teknik, që përfshin të gjitha ekzaminimet e situatës ekzistuese. Aty do të numërohen një nga një edhe një herë të gjithë konsumatorët.

Ajo që na garanton ne se çdo konsumator do të jetë i lidhur e do të përfshihet edhe matësi, është tipi i kontratës. Duke qenë kontratë me çelësa në dorë, kjo e detyron kontraktorin që projektin në tërësinë e vet, me gjithë detajet teknike, ta përfundojë e ta dorëzojë siç kërkohet.

Pra, nëse do të jenë 3600 matës, do të instalohen 3600.

Fatmir Xhafaj – Kështu është marrëveshja.

Po. Në rregull!

Faleminderit!

A ka pyetje tjetër?

(Diskutime pa mikrofon)

Të mbarojmë me pyetjet.

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord, dakord! Më vjen keq! Ju lutem!

A ka pyetje të tjera?

(Diskutime pa mikrofon)

Po, se kur e kemi pasur ne, ka shkëlqyer opozita. Ne e kemi bërë edhe opozitën.

(Diskutime pa mikrofon)

Blendi Klosi – Kam unë një pyetje.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Klosi ka pyetje.

Blendi Klosi – Kontributi i deputetit të zonës dhe i deputetëve të tjerë të zonës ka qenë evident në marrëdhëniet me publikun. Unë kam ndjesinë se deputeti ka punuar shumë me opinionin publik dhe ka pasur një përgjegjësi të qytetarëve të komunitetit të Peshkopisë e të gjithë Dibrës për këtë vepër që po bëhet. Është ajo që thotë zoti Fino, që është shumë e rëndësishme për të shkuar te pagesa e ujit në qytet. Unë do të doja ta falënderoja këtu deputetin për punën shumë të mirë që ka bërë, por a ka një ndërjegjësim të opinionit publik për investimin e madh që po bëhet?

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Peza, për procedurë, ju lutem!

Dashamir Peza – Mbas pyetjeve, lejohen duartrokitjet?

Fatmir Xhafaj – Jo, në rregulloren aktuale jo, por do ta shqyrtojmë që, kur ka pyetje shumë, të ketë edhe duartrokitje, sidomos kur vijnë nga opozita.

Zoti Gjika, ju lutem, përgjigjuni! Pa duartrokitje.

Jovan Gjika – Patjetër që këto projekte inicohen nga fushatat vendore, që përfshijnë në këtë rast, meqenëse jemi në fushën e ujësjellësit, edhe bashkitë, edhe deputetin e zonës, dhe çdo gjë bëhet hap pas hapi. Gjithsesi, edhe gjatë fazës së ndërtimit, e cila do të jetë një fazë e konsiderueshme, popullsia do ta shohë se atje po bëhet një investim dhe nuk është se ne e fillojmë nga zeroja. Atje ka një ndërmarrje ujësjellësi. Edhe sot faturohen e mblidhen të ardhura. Çështja është të shkojmë e të garantojmë 24 orë furnizim me ujë dhe furnizim të qëndrueshëm.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? S'ka.

A ka diskutime? Po, zoti Fino!

Bashkim Fino – Faleminderit që më dhe fjalën, por ajo që më shqetëson dhe që, le të themi, nuk besoj shumë është ajo që thotë përfaqësuesi që mbron kontratën këtu, zoti Gjika, i cili thotë se, pavarësisht se në relacionin e projektligjit janë vënë 3500 matës, ne në tremujorin e parë do të bëjmë një ratifikim, ose si të thuash një koordinim të fundit me ndërmarrjen e ujësjellësit.

(Diskutime pa mikrofon)

Verifikim. Koordinim. Pra, një verifikim të fundit, dhe, në qoftë se do të ketë 3600 matës, do të vëmë 3600. Këtu nuk është fjala për ta kaluar ne këtu në komision, sepse ne, natyrisht, duhet ta miratojmë sa më shpejt një marrëveshje të tillë, se është me

leverdi për qytetin e Peshkopisë, në leverdinë tonë, që vërtet të ketë ujë 24 orë dhe të jetë një ujësjellës modern, që të shkojë uji te qytetarët dhe qytetarët të paguajnë rregullisht faturat e tyre, por problemi është: sa ne do ta realizojmë këtë investim me parametra siç i kanë ata sot në Austri. Madje, në Austri, ju e dini se pinë ujë nga uji i çezmës, sepse ujin e çezmës e kanë shumë të mirë, nuk e marrin ujin me shishe, siç e marrim ne. Unë dua që, parametrat që ka sot Europa, sidomos në ujë, t'i kemi edhe ne, sepse ne jemi vendi i dytë e i tretë në Europë, pas Norvegjisë, për nga burimet ujore, se e ka thënë edhe kryeministri ynë, ndaj është absurde të bëjmë investime, të paguajmë kaq milionë euro, të cilat janë kredi që, në fund të fundit, i paguajnë kalamajtë tanë. Pra, të bëhet një ujësjellës për të qenë, jo një ujësjellës sa për të kaluar radhën.

Zoti Manja, e kam edhe për ty, cilësia e ujësjellësit duhet të jetë e tillë që uji të jetë i pijshëm, që të mos blejnë më me shishe. **Në** mënyrë të veçantë, ajo që më shqetëson më shumë, është cilësinë e investimit, për të paguar e për të mos pasur humbje në rrjet.

Ju këtu nuk më garantoni dot mua duke më thënë me një fjali: mos u mërzit, zoti Fino, se unë e kam vënë në relacion 3500 matës, por nga tre muaj që do të bëjmë rakordimet me ta, mund ta bëjmë edhe 3600. Kjo nuk më bind mua. Pse nuk më bind? Mua mund të më bindni personalisht tani. Problemi është si do ta shkruajmë në marrëveshje, zoti kryetar? Si duhet bërë në kontratë që vërtet i gjithë ky ujësjellës të ketë matës në çdo familje për të paguar me kartë? Ata a mund të paguajnë me kartë siç marrin rrogën? Me kartë-kredit? Pra, me kartë-kredi të vijë e të paguajë qytetari i Peshkopisë? Sepse bëhet investim i ri. Është një investim evropian. Hajde ta bëjmë kështu. Të paguajë me kartë për ujin që harxhon. T'i ndërpritet uji, nëse nuk paguan, ndërsa familjet e tjera ta kenë ujin 24 orë.

Çfarë dua të them me këtë diskutim? Dua të them se ne duhet të këmbëngulim tani e tutje që investimet të jenë shumë cilësore, të jenë tamam evropiane.

Unë nuk e di, por do të desha, zoti kryetar, duke qenë në parim dakord për ta miratuar këtë, që kur të firmoset kontrata, se, pasi kalon në parlament, do të ratifikohet e firmoset, një kopje e kontratës, në funksion të kësaj që ne miratojmë në parlament, të na vijë edhe ne këtu në komision, për të qenë i qetë unë, me këtë diskutim që bëj sot, në këtë mbledhje të komisionit.

Faleminderit shumë!

Fatmir Xhafaj – Ka diskutime të tjera?

Në parim edhe unë e mbështes kolegun Fino, për shkak edhe të një historiku që kanë marrëveshjet e kësaj natyre dhe produkteve të tyre në jo pak qytete të Shqipërisë jemi detyruar t'u kthehemi e t'u rikthehemi, të bëjmë shtesa marrëveshjesh, shtesa fondesh, e të tjera e të tjera. Do t'i sugjeroja relatorit, natyrisht dhe këshilltarëve, që në relacionin që do t'i çojnë Kuvendit, t'i tërheqin vëmendjen ministrisë përgjegjëse dhe Ministrisë së Financave për këtë fakt.

Në rregull.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenime s'ka.

Miratohet.

Neni 1. Dakord.

Neni 2. Dakord.

Në tërësi? Dakord? Kundër? Abstenime s'ka.

Miratohet në tërësi.

Faleminderit përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.07.2014 ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007
"Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj,
Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Armando Prenga,
Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Silva Caka
dhe Mark Frroku.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Tom Doshi, Arben Ristani, Eduard Halimi, Kastriot Islami,
Gent Strazimiri, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Mhill Fufi
dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Gentiana Sula – zëvendësministre e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Silvana Banushi – drejtore e Përgjithshme e MMSR-së

Ermira Shtino – drejtore e ish të Përndjekurve Politike

Bilal Kola – kryetar i Institutit të ish të Përndjekurve Politike

Erald Mihali - specialist në Drejtorinë e Pagesave dhe të Dëmshpërblimeve në Ministrinë e Financave

Fatmir Xhafaj – Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar”, iniciativë e Këshillit të Ministrave, i iniciuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë, ministria që mbulon fushën, ministria përgjegjëse.

Nga ministria janë të pranishme zonja Gentiana Sula, zëvendësministre e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë.

Faleminderit!

Zonja Silvana Banushi, drejtore e Përgjithshme e kësaj ministrie.

Zonja Ermira Shtino, drejtore e Drejtorisë së ish-të Përndjekurve Politikë.

Zoti Bilal Kola, kryetar i Institutit të ish- të Përndjekurve Politikë.

Kolegu Kola, mirë se keni ardhur!

Erald Mihali, specialist në Drejtorinë e Pagesave e Dëmshpërblimeve të Ministrisë së Financave. Shumë mirë! Duhet edhe Ministria e Financave, që të kontrollojë apo të japë paratë në kohë.

Atëherë, fillojmë shqyrtimin e këtij projektligji të rëndësishëm, në të cilin ne jemi për dhënie mendimi. Komisioni përgjegjës është Komisioni i Ekonomisë, i cili besoj se do ta shqyrtojë këto ditë projektin.

Fillimisht do të dëgjojmë një përmbledhje, një ekspozë të shkurtër të përfaqësuesve të ministrisë. Pastaj do të dëgjojmë relatorin, zoti Pandeli Majko për projektin.

Besoj se zonja Sula do të bëjë një paraqitje të shkurtër, duke qenë se kolegët janë njohur me të nga relacioni dhe nga të gjitha materialet që ju keni sjellë.

Po, zonja Sula.

Gentiana Sula – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderojmë për ftesën.

Siç e thatë, jemi këtu përfaqësues të tri ministrive, për të parashtruar disa ndryshime në ligjin e dëmshpërblimit të ish – të dënuarve politikë gjatë regjimit komunist.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka marrë në fushën e veprimit të saj edhe integrimin e ish-të dënuarve politikë, por për këtë projektligj kemi bashkëpunuar me një komision treministrior: Ministrisë së Drejtësisë, kemi kolegun këtu, dhe të ministrisë sonë, njëkohësisht edhe me Institutin. Në përgjithësi skema është hartuar dhe miratuar nga parlamenti në vitin 2007.

Ne bëmë një analizë të performancës së skemës dhe rezultoi se skema nuk është implementuar siç duhet, ka pasur pabarazi në mënyrën se si është proceduar me shpërndarjen e kësteve, Ka qytetarë, disa mijëra, dosjet e të cilëve nuk janë shqyrtuar ende nga Ministria e Drejtësisë. Disa mijëra dosje flinin në Ministrinë e Financave dhe nuk kishin marrë asnjë këst. Ndërkohë, disa kishin marrë një këst ose disa kishin marrë dy këste.

Projektligji çalonte sepse nuk kishte bërë një shpërndarje të barabartë nëpërmjet shtresave që ishin përfituese. Ne u konsultuam me grupet e interesit. I kemi takuar pothuajse të gjitha shoqatat dhe në përgjithësi na rezultoi se kërkesa e tyre është që të priorizoheshin ish-të dënuarit që ishin gjallë, sidomos ata që ishin më të moshuar. Kjo është edhe në programin e qeverisë. Programi i qeverisë, që është miratuar vjet në parlament, e vinte theksin te kjo shtresë pikërisht që të shpërblente në bazë të gjinisë, pra gratë përpara burrave, të vjetrit para më pak të vjetërve dhe njëkohësisht të favorizonte ata ish-të dënuar që jetojnë ende sot.

Gjatë punës sonë patëm parasysh dy parime: transparencë dhe solidaritet.

Kur flas për transparencë, pikësëpari bëmë inventarët e dosjeve, kudo që ishin. Na rezultuan rreth 20 mijë dosje të pashqyrtuara, i keni edhe në relacion shifrat. Pamë se kishte pabarazi dhe menduam të bëjmë një transparencë të plotë, dhe relacioni e përmban, qoftë për sa i përket kategorisë së atyre që janë gjallë dhe sa është **implikimi** financiar i kësaj kategorie. Bëmë edhe një analizë me bazë gjinore. Na rezultuan një grup i vogël i grave që jetojnë.

Parimi i dytë që adoptuam si grup pune ishte parimi i solidaritetit. Jo vetëm barazi në shpërndarje, por njëkohësisht ata që kanë vuajtur më shumë të përfitonin të parët.

Në bazë të këtyre parimeve përpiluam një skemë dhe ia propozuam Këshillit të Ministrave, i cili e miratoi. Sipas kësaj skeme, fondi vjetor, që përcaktohet nga buxheti publik për dëmshpërblimet, të ndahet në dy kategori: në kategorinë e grupit parësor dhe

në kategorinë e grupit tjetër. Në grupin parësor u futën pikërisht ata persona që ishin gjallë.

Kur bëmë një analizë social-ekonomike të këtyre personave, na rezultoi se jo vetëm të moshuarit kishin nevojë, por sidomos ishte një nevojë akute për financim, për mbështetje ekonomike, për të marrë dëmshpërblimin po aq shpejt sa të moshuarit kategoria e atyre që nuk kishin as moshë pensioni, që shpeshherë na rezulton se janë të papunë dhe që kanë fëmijë të mitur, domethënë që e kanë ende sfidën për të rritur fëmijët e tyre. Kështu që kompozuam një grup parësor të subjekteve përfituese, i cili përbëhet, me rend prioritar: gratë të parat, të moshuarit mbi shtatëdhjetë e pesë vjeç, si kategori, të moshuarit nën shtatëdhjetë e pesë vjeç, ku veçojmë ata që janë të sëmurë, të përcaktuar nga një akt nënligjor, që do të hartohet në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, ata që kanë fëmijë të mitur, qofshin ata që jetojnë ose ata që nuk jetojnë dhe pastaj ata që janë nën shtatëdhjetë e pesë vjeç.

Domethënë të mbajmë ndarjet me tetë këste, sikurse ka filluar operacionalizimi i dëmshpërblimit, por brenda çdo kësti të ruajmë këtë ndarje.

Ndryshimi i dytë që propozojmë buron nga fakti që vetë livrimi i fondit brenda Ministrisë së Financave ka pasur disa shqetësime për vetë faktin se ka mijëra dosje që nuk kanë marrë asnjëherë asnjë këst.

Ne bëmë një analizë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe rezulton se shpeshherë se për ish- të dënuarit që nuk jetojnë, me akt trashëgimie, e drejta e dëmshpërblimit i kalon grupit të familjarëve të tyre. Mirëpo, nëse njëri nga trashëgimtarët nuk kishte bërë dokumentacionet përkatëse, gjithë kategoria e trashëgimtarëve të këtij personi nuk përfitonte nga dëmshpërblimi dhe mbeteshin disa mijëra dosje të patrajtuara, në pritje të plotësimit të dokumentacionit. Për këtë arsye u propozua që dosja të trajtohet si e tillë dhe vetëm trashëgimtarin që nuk ka aplikuar ose nuk ka plotësuar dosjen, ta presim deri në tre muaj e pastaj të kalojë në këstin tjetër. Ndërkohë, dosja vazhdon shqyrtimin dhe trashëgimtarët e tjerë vazhdojnë ta përfitojnë dëmshpërblimin.

Pra, ndryshimet që propozojmë kanë të bëjnë me përcaktimin e grupit prioritar dhe me përmirësimin e fluksit të shpërndarjes së fondeve nga një këst tek tjetri, duke ndarë personin që nuk ka plotësuar dosjen me trashëgimtarët e tjerë.

Ndryshimi tjetër është shumë i rëndësishëm dhe ka të bëjë me ndarjen e fondit në 70% e 30%. 70% për grupin prioritar dhe 30% për grupet e trashëgimtarëve.

Si skemë kemi dalë publikisht që më 20 maj, e kemi ndarë publikisht nëpërmjet mediave në konferencë për shtyp, intervistave e raporteve të gjata në medien e shkruar, kemi bërë kontakte me një grup të madh shoqatash, që janë grupe përfituese, kemi nxjerrë në internet, kemi vënë numër telefoni dhe e-mail, që të marrim komente. Në përgjithësi e kemi shpjeguar dhe na rezulton se në përgjithësi skema është vlerësuar.

Ky ishte, me pak fjalë, një lloj përshkrimi i punës.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Sula, për ekspozenë, për paraqitjen që i bëtë iniciativës!

Tani do të dëgjojmë relatorin e projektligjit, zotin Pandeli Majko.

Pandeli Majko – Unë nuk do t'i shtoja shumë asaj që tha zëvendësministria. Gjatë kësaj periudhe ne kemi pasur një komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për këtë projektligj. Është pa dyshim një projektligj shumë sensitiv. Kjo ka qenë edhe arsyeja që ne i jemi drejtuar edhe prezencës së OSBE-së për të dhënë mendimet e veta për këtë projektligj.

Me kënaqësi dëshiroj të them se edhe me mirëkuptimin e ministrisë, të gjitha vërejtjet që ka bërë OSBE-ja dhe vërejtjet që ne kemi bërë këtu, si relatorë, së bashku me zotin Subashi, janë përfshirë.

Dëshiroj të nënvizoj faktin, jo për të justifikuar logjikën pse po i bie pak shkurt, por ne nuk jemi komision përgjegjës, ne shikojmë vetëm këndvështrimin e përputhjes me Kushtetutën dhe disa elemente të rëndësishme, që kanë të bëjnë me këtë çështje kaq sensitive.

Për mua është një punë shumë e mirë e filluar, nuk mund të them e mbaruar, për të strukturuar marrëdhënien ligjore të shtetit me këtë kategori sociale. Sigurisht, duhet një dialog në vazhdim me këta njerëz, pasi ne ende i shohim të hyrja e parlamentit që protestojnë, që do të thotë se dialogu me ta duhet mbajtur në mënyrë permanente.

Dëshiroj të nënvizoj dhe të përgëzoj ministrinë, që në krye të listës, në këndvështrimin e këtij ligji, ka vënë kompensimin e të dënuarve gra. Mendoj se identifikimi si prioritet i të dënuarve femra është jashtëzakonisht i rëndësishëm, pastaj duke ardhur me radhë ata që janë mbi 75 vjeç, me sëmundje të rëndë e kështu me radhë.

Ky kategorizim mendoj se do të jetë shumë i vlerësuar edhe për të mos pasur dallime, ashtu siç e nënvizoi edhe zëvendësministria, të cilat pastaj krijojnë një lloj kaosi dh keqkuptime për mënyrën sesi shteti e trajton këtë shtresë.

Nuk kam komente të tjera. Të gjithë kolegët besoj se e kanë relacionin përpara tyre. Kush ka nevojë për pyetje, le t'i bëjë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko!

Siç e thashë, ne nuk jemi komision përgjegjës, por jemi komision për dhënie mendimi. Komisioni përgjegjës, natyrisht, ka detyrimin ose nevojën, sipas rastit, për të kontaktuar dhe për ta diskutuar, nëse është e nevojshme, edhe me grupet e interesit. Unë shpresoj që ministria ta ketë realizuar më së miri këtë proces. Do të dëshiroja nga zonja zëvendësministre dhe nga zoti Kola lidhur me faktin. Një shpjegim më të qartë lidhur me faktin se si është konsultuar ky projektligj me grupet e interesit.

Nëse ka nevojë për më shumë, është çështje që i përket komisionit përgjegjës. Te ne nuk ka kërkesa të depozituara nga grupet e interesit, për t'u dëgjuar. Nuk ka kërkesa as nga deputetët, sipas Rregullores, që të dëgjojnë grupe interesi. Do të ishte në interes të shqyrtimit të objektit, në interes të opinionit publik dhe të vetë grupeve të interesit, nëse do të kishit një koment të shkurtër rreth këtij fakti.

Gentiana Sula – Hapi i parë ishte që kemi marrë kontakt me grupet e interesit për të parë se cilat janë mendimet e tyre në raport me dëmshpërblimin, por edhe me çështje të tjera të integritetit social, ekonomik dhe moral të shtresës. I kemi të dokumentuara propozimet që kanë bërë disa prej tyre. Mund të veçoj Shoqatën e të Internuarve, Shoqatën e të Dënuarve dhe të Pushkatuarve pa Gjyq, Unionin Mbarëkombëtar. Mund t'ju vëmë në dispozicion listën e organizatave që kemi dëgjuar, se si e kanë menduar ato skemën. Deri me 20 maj dhamë fjalën publikisht që skema do të bëhej publike, siç e kemi menduar ne, dhe është organizuar një konferencë për shtyp, për ta marrë vesh gjithë publiku. Duke menduar që shoqatat përfaqësojnë, por jo të gjithë komunitetin dhe shoqërinë. Në fund të fundit, është një dëmshpërblim që buron nga të gjithë taksapaguesit dhe gjithë shoqëria do të ishte e interesuar. Pastaj, kemi bërë takime bilaterale me disa prej organizatave. I kam takuar personalisht. Edhe ministri i ka takuar personalisht. Si

dhe kolegët. Janë konsultuar pothuajse të gjitha shoqatat që janë të listuara dhe punojnë me ne.

Ka prej atyre që kanë pretendime të ndryshme. Një nga problemet ka qenë mungesa e transparencës. Në përgjithësi, nuk janë bërë transparente faturat financiare, ose shifrat e përfituesve. Ne ua kemi vënë në dispozicion, me lista të plota dhe ua kemi bërë të qartë se për çfarë bëhet fjalë. Kërkesa kryesore e tyre është ritmi i dëmshpërblimit. Ne kemi dhënë një premtim publik që të paktën kategoria parësore të shpërblehet deri në fund të mandatit qeverisës. Kjo do të jetë lufta jonë, që brenda buxheteve të qeverisë të mund të shlyejmë këtë kategori. Lajmi i mirë është që vitin tjetër, në planin afatmesëm buxhetor, qeveria ka parashikuar rreth 2 milionë dollarë më shumë, nga 18 milionë do të shkojë në 20 milionë. Kryeministri është i angazhuar personalisht që kjo të rritet në bazë të perspektivës ekonomike të vendit. Ky ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm i grupeve të interesit.

Ka qenë një grup që thoshte: “Na jepni ne mbi 80 vjeç. Apo mbi 75.” Kur e panë që kjo implikonte që të lireshin jashtë radhe për disa bashkëvuajtësit e tyre, ata kanë hequr dorë. Disa grupe mund të mos bien dakord. Disa të tjera kanë qenë të përjashtuara. Ne kemi premtuar që do t’i shqyrtojmë kërkesat e tyre rast pas rasti. Ata kërkojnë amendime ose zgjerime nga ligji ekzistues. Janë kërkesa që nuk u kemi thënë “po” ose “jo”. Grupi do të vazhdojë t’i shqyrtojë. Ka pasur kërkesa për shtimin e afatit. Ka pasur pretendime për mungesën e akteve nënligjore, për sa u përket të internuarave në tela me gjëma, për sa u përket presioneve të të internuarve: kërkesa që i kemi listuar dhe i kemi në prioritetet tona për 300 ditshin e dytë. I kemi nxjerrë në faqen e internetit të Ministrisë, me numër telefoni, me *website*. Kemi dhënë disa intervista në media dhe kemi pasur disa takime bilaterale. Kjo ka qenë pak a shumë puna intensive që kemi bërë. Jemi në gjendje të japim lista shoqatash që janë takuar dhe konsultuar.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Sula!

Zoti Kola.

Bilal Kola - Faleminderit, zoti kryetar!

Nisur edhe nga periudha shumë e shkurtër që jam në këtë detyrë, por duke e parë me prioritet absolut faktin që kemi një projektligj në këtë stad, kur u ngrit një pretendim nga kryetarja e Komisionit të Çështjeve Sociale dhe të Shëndetësisë që disa grupe interesi

nuk qenë konsultuar, meqenëse u përmend nominalisht se kush nuk qe konsultuar, mora shkas që të kem një kontakt të drejtpërdrejtë me këta individë. Ajo që konstatova qe se nga disa shoqata ka një konfondim midis objektit që trajton ky projektligj dhe gjithë çështjes së përndjekjes politike. Të paktën, këtë konstatova unë. Nisur nga kjo, vura re se ka disa elemente thellësisht dhe thellësisht politike që nuk janë objekt i këtij projektligji. Mendoj se objekti që ka ky projektligj është konsultuar me grupet e interesit. Kuptohet, disa prej tyre nuk janë të impresionuar shumë nga skema. Megjithatë, mund të them se grupet e interesit janë të konsultuara.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit për përgjigjen!

Ka pyetje të tjera?

Zonja Caka.

Silva Caka – Po shikoja prioritet dhe më bëri përshtypje diçka. Mbase gabohem. Në radhën e katërt, keni vendosur ish të dënuarit politikë të cilët kanë pasardhës të radhës së parë në moshë të mitur. Ndërkohë që radha e pestë janë të ish të dënuar politikë që nuk jetojnë. Pak a shumë është e njëjta gjë. Vetëm se këtu ish i dënuari politik nuk jeton. A nuk mendoni se kjo duhej të ishte kategoria e katërt dhe jo e pestë? Te kategoria e katërt ish i dënuari jeton dhe mund të kujdeset për pasardhësit e mitur, kështu që këta të kategorisë së pestë duhej të kishin më shumë prioritet.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Sula.

Gentiana Sula – Mendoj se sugjerimi ka vend. Megjithatë, që ta kuptojmë, bëhet fjalë për një javë përpara ose një javë më prapa. Sidoqoftë, qëndron. Do ta shikojmë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? S’ka.

Diskutime? S’ka.

Kush është dakord në parim? Kundër? abstenim?

Miratohet.

Fillojmë nen për nen.

Zonja Sula, ju keni një tabelë (e kanë edhe deputetët), ku janë vërejtjet që keni diskutuar paraprakisht me relatorin dhe këshilltarët, në të cilat janë reflektuar edhe

sugjerimet e bëra nga OSBE-ja, me ndonjë gjë të vogël që duhet ta shikojmë. E keni përpara?

Fillojmë me nenin 1, ku ka më shumë ndryshime të karakterit të sistemimit dhe të teknikës legjislativë.

Jeni dakord?

Dakord.

Nga kolegët?

Ermonela Felaj – Shoh që në paragrafin II të nenit të projektit, në disa germa projekti e lidh efektivitetin e vet “bëhen të zbatueshëm në momente të ndryshme”. Një herë thuhet...

Fatmir Xhafaj – E kanë rregulluar “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji”.

Ermonela Felaj – Duhet sistemuar.

Fatmir Xhafaj – E kanë sistemuar.

Ermonela Felaj – Nuk do të isha dakord për ndryshimin e radhëve: të dalë germa “dh” para germës “d”, sepse ka një arsye ligjore se pse duhen vendosur përpara ish të dënuarit politikë që nuk jetojnë dhe kanë trashëgimtarë të radhës së parë, që janë në moshë të mitur. Është rezerva ligjore, duam apo s’duam ne, duhet respektuar edhe me këtë ligj. E parashikon Kodi Civil që është ligj me 3/5. Natyrisht, është në hierarki më lart sesa ky ligj. Është në rregull dhe nuk duhet bërë ndryshimi.

(Diskutime pa mikrofon.)

Me vërejtjet e bëra, kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 2.

Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Te neni 3 janë bërë disa ndryshime që kanë të bëjnë me mënyrën e komunikimit. Janë reflektuar edhe vërejtjet e arsyeshme të prezencës së OSBE-së.

Erald Mihali - Në lidhje me nenin 3, për pjesën e afatit 15 ditor për kthimin e përgjigjeve për personat që nuk plotësojnë dokumentacionin, Ministria e Financave apo drejtoria përgjegjëse nuk mund t’u dërgojë letra përfituesve kur nuk ua di adresën. Nuk mund ta marrim ne iniciativën, por vetë personat.

Fatmir Xhafaj – Më fal, por unë nuk e shikoj që duhet t’ia dërgoni ju. Ku e lexoni ju këtë?

Erald Mihali – “Kur një ish i dënuar politik apo trashëgimtar i tij nuk dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda fatit...”

Fatmir Xhafaj – Dakord. Po më lart e ke lexuar?

Erald Mihali - Thuhet se ai ose ajo njoftohet lidhur me përfundimin brenda 15 ditëve. Kur nuk ka adresa...

Fatmir Xhafaj – Ai ka plotësuar dokumentacionin, si nuk paska adresë?

Erald Mihali – Ai mund ta dorëzojë dokumentacionin direkt në protokollin e Ministrisë dhe nuk ka adresë. Maksimumi lë një numër telefoni.

Fatmir Xhafaj – Njoftim është dhe numri i telefonit. I lini detyrë protokollit tuaj që ta marrë adresat, se është elementare. As këtë nuk e bën dot Ministria?

Erald Mihali – Janë 12-13 mijë dosje.

Fatmir Xhafaj – Ta gjejë Ministria. Për këtë punë është.

Erald Mihali – Të paktën, të zgjasim afatin 15 ditor. E vëmë 30 ditë.

Fatmir Xhafaj – E njëjta logjikë është, megjithatë dakord.

Dakord, me sugjerimin e kërkuar, zonja Sula?

Dakord.

Faleminderit!

Ju të medias, mos u hutoni, sepse do ta merrni kopjen: do t’jua japin përfaqësuesit e Zyrës së Shtypit.

Dakord, me nenin 3, me vërejtjet e sugjerimet e bëra? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 4, që ndryshon nenin 15.

Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5 (neni 16, që shfuqizohet).

Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6, me vërejtjen që është bërë: “Këshilli i Ministrave miraton afatet dhe skemën e shpërndarjes së fondeve”.

Zonja Sula, dakord?

Dakord.

Kolegët.

Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7, që shfuqizon nenin 33.

Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Shtohet neni 8, që thotë “Ngarkohet ministri i Financave të nxjerrë brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji udhëzimin sipas përcaktimeve të bëra në nenin 4 të këtij ligji”.

Zonja Sula, dakord? Dakord.

Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8, që bëhet neni 9, “Hyrja në fuqi”, “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Janë të mjaftueshme 15 ditë? Dakord.

Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Faleminderit përfaqësuesve të të dy ministrive!

Punë të mbarë!

Zoti Kola, edhe në emër të kolegëve të Komisionit, urime për detyrën e re! Besoj se do të kemi mundësi që të bashkëpunojmë sërish, në vijim të një bashkëpunimi shumë të gjatë.

Gjithë të mirat!

Përfaqësuesit e Zyrës së Shtypit të Kuvendit, ju lutem, të vënë në dispozicion të medias ndryshimet e bëra.

Njoftoj kolegët në orën 16:30 do të kemi mbledhjen e komisionit “Për Kodin Doganor”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.07.2014 ora 16:30

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Silva Caka dhe Mark Frroku.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Tom Doshi, Spartak Braho, Arben Ristani, Edi Paloka, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Mhill Fufi dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Elisa Spiropali – drejtore e Përgjithshme e Doganave

Ervina Domi – drejtore Juridike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

Blerta Kraja – zëvendës drejtore e Përgjithshme e Doganave

Genc Celi – drejtor i Tarifës dhe Origjinës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përsëendetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit. Seancën e konsideroj të çelur.

Kemi për shqyrtim vazhdimin e Kodit Kodanor. Pasi është votuar në parim, kemi miratuar, me vërejtjet dhe sugjerimet përkatëse, 15 nenet e para.

Neni 13 është lënë për t'u diskutuar në fund, para votimit në tërësi.

Do të vazhdojmë me nenin 16.

Në këtë mbledhje është drejtoresha e Doganave, zonja Elisa Spiropali, së bashkë me ekipin e bashkëpunëtorëve të vet, për të kontribuar në shqyrtimin dhe miratimin e neneve përkatëse.

Fillojmë me nenin 16.

Relatori. Ju lutem, përpara keni përfaqësuesit e Drejtorisë së përgjithshme të Doganave. Kanë përpara projektin që e kanë dakordësuar në një pjesë të konsiderueshme me stafin e Komisionit, kështu që mund të vazhdojmë nën për nen, pa shumë komente.

Fillojmë me nenin 16.

Armando Subashi – Faleminderit, kryetar!

Te neni 16 sugjerohet që pika 3, 4 dhe 5, të shkrihen në një pikë të vetme, me përmbajtje si vijon: “Personeli doganor duhet të shmangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës në shërbim, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Ka komente? Dakord?

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Nga kolegët? Dakord?

Dakord.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 17.

Armando Subashi – Nuk ka pasur vërejtje. Nuk e di nëse ka nga kolegët.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Kam diçka të vogël te titulli i Kreut III, ku thuhet “Të drejtat dhe detyrimet përkundrejt legjislacionit doganor”. Ndërsa te paragrafi i parë ju thoni që “shkëmbimi i informacioneve bëhet duke përdorur teknika informatike të përpunimit të të dhënave”. Mendoj se duhet zëvendësuar “përkundrejt”, por edhe “teknika informatike të përpunimit të të dhënave” duhet të jetë më e qartë.

Fatmir Xhafaj – Po.

Vazhdoni me prezantimin.

Ervina Domi – Ervina Domi. Drejtore Juridike.

Kjo dispozitë përcakton edhe një prej risive që ka Kodi Doganor aktual. Do të thotë që do të shkojmë drejt një sistemi informativ të Doganës. Përmes këtij neni dhe gjithë dispozitave që vijnë pas, është përcaktuar që në vazhdimësi, pra në vitin 2017, por maksimumi në vitin 2021, çdo veprim që do të kryhet në sistemin doganor do të bëhet në mënyrë elektronike. Për këtë qëllim, Dogana ka filluar punën që të miratojë nënshkrimin elektronik. Njëkohësisht, edhe aplikimi kryhet online. Edhe kërkesa për vendimmarrje do të bëhet në mënyrë elektronike.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Jam dakord me këtë sqarim, por te pjesa e përkufizimeve nuk është dhënë, si dhe nuk është thënë diku përpara, që të t’i paraprijë, që me sot e tutje kjo do të bëhet nëpërmjet komunikimit elektronik. Kjo është gjë shumë e mirë, por duhet sqaruar. Kur thoni “teknika informatike”, mos harroni që ka edhe të dhëna që janë personale. Prandaj ju pyeta: keni ndonjë detyrim për të mbrojtur të dhënat personale? Kjo duhet sqaruar, duke respektuar kërkesat dhe ligjet përkatëse.

Te Kreu III, të lutem, zëvendësimi i “përkundrejt”. Keni dashur të thoni “të drejtat dhe detyrimet e personave sipas legjislacionit doganor”, apo “të drejtat dhe detyrimet e... kujt... në zbatim në legjislacionit doganor”?

Ervina Domi – Sipas legjislacionit, biem dakord. Nuk përbën problem. Ndërkohë, në lidhje me konfidencialitetin, është përcaktuar neni 20, më poshtë, “Detyrimi i Doganës për të ruajtur konfidencialitetin dhe...”.

Fatmir Xhafaj – Ka kush vërejtje? S’ka.

Dakord?

Miratohet neni 17.

Neni 18.

Armando Subashi – Neni 18 titullohet “Aktet zbatuese”. Propozimi është që, jo vetëm këtu, por në të gjithë ligjin, kjo të zëvendësohet me “Aktet nënligjore”.

Elisa Spiropali – Kemi rënë dakord.

Fatmir Xhafaj – Ka kush vërejtje? S’ka.

Dakord?

Miratohet.

Neni 19. Ka kush vërejtje? S’ka.

Dakord?

Miratohet neni 19.

Neni 20, “Komunikimi i informacionit dhe mbrojtja e të dhënave”.

Ka kush vërejtje? S’ka.

Dakord?

Miratohet.

Neni 21.

Armando Subashi – Te neni 21, pika 1, propozohet që pas fjalëve “operatorë ekonomikë” të shtohet “në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Ka kush vërejtje? S’ka.

Dakord?

Miratohet.

Neni 22.

Armando Subashi – Te neni 22, pika 1, sugjerohet të formulohet si vijon dhe të ndahet në dy pika:

“1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare që kanë të bëjnë me veprimtarinë e autoriteteve doganore në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, për sa kohë nuk është përcaktuar ndryshe në këtë Kod.

2. Çdo person mund të kërkojë informacion në lidhje me rregullat dhe zbatimin e procedurave doganore nga autoritetet doganore. Një kërkesë e tillë mund të refuzohet, nëse nuk ka lidhje me një aktivitet që ka të bëjë me tregtinë ndërkombëtare të mallrave dhe që do të kryhet realisht”.

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Ka kush vërejtje? S’ka.

Dakord?

Miratohet.

Kalojmë te neni 23.

Armando Subashi – Te neni 23, pika 2, sugjerohet që togfjalëshi “e bën personin e interesuar përgjegjës për...” të zëvendësohet me “e bën këtë person përgjegjës për...”.

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Ka kush vërejtje? S’ka.

Dakord?

Miratohet.

Kalojmë te neni 24. Ka kush vërejtje? S’ka.

Dakord?

Miratohet.

Neni 25.

Armando Subashi – Te neni 25 ka dy ndërhyrje të vogla: te pika 1, paragrafi i dytë, ku shtohet “pa aktin ligjor të përfaqësimit për të vepruar si i tillë”, dhe te pika 2, mbas fjalëve “është lëshuar akti ligjor i përfaqësimit nga i përfaqësuari”. Thjesht, rregullime teknike edhe këto.

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Ka kush vërejtje? S’ka.

Dakord?

Miratohet.

Meqenëse përfaqësuesit e qeverisë, që përfaqësohen nga drejtoresha me ekipin e vet, e kanë këtë draft, si edhe kolegët deputetë, sikur të mos e lexojmë, që të fitojmë kohë.

Armando Subashi – Dakord, por si do të pasqyrohet procesverbali?

Fatmir Xhafaj – Do të pasqyrohet në procesverbalin përfundimtar. Kur të bëhet raporti nga këshilltarët, do të pasqyrohet. Fitojmë kohë. Ku bëj gabim, ju lutem, më ndërhyuni!

Neni 26. Dakord?

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 27. Dakord me sugjerimet përkatëse të nenit 27, pika 5? Dakord.

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 28. Dakord?

Elisa Spiropali – Dakord, me ndryshimet.

Miratohet.

Neni 29. Dakord, me ndryshimin që është propozuar? Dakord.

Miratohet.

Neni 30.

Elisa Spiropali – Ka një ndryshim. Kemi rënë dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 31, me ndryshimet e teknikës legislative. Dakord?

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 32.

Elisa Spiropali – Ka një ndryshim. Kemi rënë dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 33.

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kolegët s'kanë gjë.

Miratohet.

Neni 34.

Fatmir Xhafaj – Kolegët, dakord?

Dakord.

Miratohet.

Neni 35, me ndryshimin e bërë që në fillim, lidhur me termin “aktet zbatuese”.

Dakord?

Dakord.

Miratohet.

Neni 36.

Elisa Spiropali – Dakord me ndryshimet.

Fatmir Xhafaj – Kolegët, dakord?

Dakord.

Miratohet.

Neni 37.

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 38. Dakord?

Dakord.

Miratohet.

Neni 39.

Dakord?

Dakord.

Miratohet.

Neni 40.

Elisa Spiropali – Ka një ndryshim. Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 41, “Dhënia e statusit”.

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 42. Dakord? Dakord, me sugjerimin që është bërë.

Miratohet.

Neni 43.

Ka kush vërejtje? S’ka.

Dakord?

Elisa Spiropali – Dakord, me ndryshimin: nga “penalitete” në “sanksione”.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 44.

Dakord?

Dakord.

Miratohet.

Neni 45.

Elisa Spiropali – Ka ndryshime. Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 46, “Pezullimi i zbatimit”. Dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 47.

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 48.

Dakord.

Neni 49 “Kontrolli i pasqyrimit të mallrave”.

Dakord?

Miratohet.

Neni 50. Dakord?

Elisa Spiropali – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Miratohet.

Neni 51, me sugjerimin që është bërë. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 52, me reflektimet që janë bërë.

Elisa Spiropali – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Miratohet.

Neni 53 “Pagesa dhe kostot”.

Elisa Spiropali – Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Miratohet.

Neni 54 “Kursi i këmbimit valutor”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 55. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 56 “Tarifat doganore dhe mbikëqyrja”. Kush është dakord? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 57 “Klasifikimi tarifor i mallrave”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 58, me sugjerimin që është bërë. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 59 “Fusha e zbatimit”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 60 “Përfitimi i origjinës”.

Zoti Vasili, keni fjalën.

Petrit Vasili – Në lidhje me këtë nen, në komisionin përgjegjës ne kemi propozuar një amendim, të cilin po e propozojmë edhe këtu, bashkë me shpjegimet përkatëse.

Ne propozojmë të shtohet një pikë 3 me këtë përmbajtje: “Organet doganore krijojnë lehtësi procedurale për t’u dhënë origjinë shqiptare mallrave që janë nën regjimin e përpunimit aktiv”.

Propozimi për këtë amendament bëhet për të lehtësuar në maksimum eksportin e mallrave shqiptare në bazë të marrëveshjeve tregtare-ndërkombëtare EFTA, CEFTA etj.

Praktika e ndjekur deri më sot nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave tregon se certifikata e origjinës është dhënë sipas preferencave individuale dhe kjo ka bërë që Kodi i vjetër Doganor të linte mjaft shtigje për abuzime. Kështu që ne kërkojmë të zbatohen të njëjtat praktika si ato rajonale, sepse të deritanishmet tregojnë se kanë qenë shumë të shtrënguara dhe me më pak hapësira sesa në vendet e tjera, gjë që u krijon problematika të mëdha bizneseve, të cilat operojnë me këto produkte. Së bashku me këtë bëhet një promovim direkt, shumë pozitiv për produkte *made in Albania* dhe njëkohësisht i jepet

një hapësirë biznesit shqiptar që të bashkëpunojë edhe me vendet jashtë rajonit, por që aktualisht e kanë të pamundur të marrin origjinën dhe grandin *made in Albania*. Në të njëjtën kohë bëhet lehtësisht e eksportueshme për tregjet e reja, të cilat kërkojnë këtë origjinë tashmë europiane të mallrave.

Pra, duke e përmbledhur, kërkojmë të shtohet një pikë 3 me këtë përmbajtje, e cila vjen edhe si një shqetësim dhe një kërkesë insistuese e bizneseve që operojnë dhe që janë të afektuar direkt nga kjo problematikë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Vasili propozoi që të shtohet një pikë 3 te neni 60 “Përfitimi i origjinës”.

Zonja Spiropali, ju lutem, komenti juaj.

Elisa Spiropali – Çështja që ngriti zoti Vasili është e përfshirë në paketën fasone, e cila është propozuar nga grupi i LSI-së. Aktualisht po diskutohet në Komisionin e Ekonomisë dhe është lënë që paketa fasone të diskutohet në një seancë përfundimtare. Pra, në çdo nen që ne kemi diskutuar aty ku preket paketa fasone kryetari i Komisionit të Ekonomisë ka vendosur që të diskutohet në fund si pjesë e paketës, jo si nen më vete.

Megjithatë, për çështjen që ngriti zoti Vasili do t’i kthejë përgjigje kolegu im, drejtori i origjinës së tarifës.

Genci Çeli – Ka një problem me këtë propozim, nuk mund të jepet certifikata e origjinës apriori për të gjitha llojet e mallrave. Certifikata e origjinës është një certifikatë që përdoret në marrëdhëniet dypalëshe. Pra, është një dokument që provon origjinën e mallrave dhe përdoret për marrëveshjen e tregtisë së lirë që kemi me Europën apo MSA-në, me Turqinë, me EFTA-n dhe me CEFTA-n. Pra, vetëm në këto katër vende funksionon. Gjithashtu është me një aneks shumë të gjatë nga mbrapa, që për çdo lloj malli të ketë njëfarë operacioni të caktuar që duhet të kryhet, në mënyrë që të përfitohet origjina. Jo të gjitha mallrat mund ta përfitojnë origjinën. Këto kanë qenë pjesë negociatash dhe tani janë pjesë e anekseve të marrëveshjeve. Pra, për çdo mall duhet të shkosh të kodi përkatës për të parë sesi përfitohet origjina, nuk mund të jepet origjina për çdo mall.

Fatmir Xhafaj – Zoti Vasili, urdhëroni!

Petrit Vasili – Së pari, për komentin e zonjës Spiropali, unë jam i ftohtë për atë që trajtohet në Komisionin e Ekonomisë. Unë bëj propozimin tim në një komision për

dhënie mendimi, siç është ky që jemi ne. Mirëkuptimin për këtë shqetësim apo shtesë e kërkoj këtu. Komisioni i Ekonomisë ka trajtimin e tij dhe vepron sipas procedurave që rregullojnë punën e atij komisioni, si komision përgjegjës. Kështu që në lidhje me këtë pikë besoj se nuk është një shpjegim që e ezauron këtu çështjen.

Në lidhje me përgjigjen që dha drejtori përkatës, besoj se duhet të tregohet vëmendja e duhur në mënyrën sesi formulohet pika. Po e lexoj edhe një herë, meqenëse nuk ka pasur vëmendjen e duhur: “Organet doganore krijojnë lehtësi procedurale...”, nuk është thënë, kushdo që punon me ligje, prioritet apo njohje automatike.

Mesazhi është të krijojmë një fleksibilitet në Kod, që kjo punë të arrihet sa më shpejt kur konditat të plotësohen. Pra, nuk është dhënë njohje automatike. Kjo, përveçse e qetëson biznesin, u jep përgjigje shumë shtrëngicave që janë krijuar, por edhe shumë elementeve ku klientelizmi ka bërë të tijën dhe e ka asfiksuar biznesin. Pra nuk u bë asgjë tjetër përveç kësaj. Qëndrimi në këtë rikiditet të mëparshëm na kthen tek ai Kod që ishim dhe nuk na çon përpara. Ne jemi thirrur këtu të kemi një kod, i cili fleksibiliton në maksimum dhe i bën organet doganore miq, në kuptimin e mirë të fjalës, jo shtrëngues të tij. Ky është thelbi i saj. Kur ka detyruese, është tjetër çështje.

Pra, arsyetimi juaj i referohet një formulimi tjetër, që unë nuk e thashë.

Fatmir Xhafaj – Besoj se tani është më e qartë për drejtorin, sepse nuk është një gjë taksative, në fund të fundit, është orientuese dhe krijon lehtësi. Por i gjithë Kodi Doganor për të krijuar lehtësi është.

Elisa Spiropali – Ne do ta marrim propozimin të shkruar ekzaktësisht, më pas këshilltarët tanë ta diskutojnë me këshilltarët tuaj dhe, nëse ka kundërshtime që nuk lidhen me dëshirën tonë për të lehtësuar procedurat, por me procedurat doganore...

Fatmir Xhafaj – Ju kërkoni kohë që të njiheni, dakord.

Elisa Spiropali – Nëse është thjesht lehtësim procedure, ne e bëjmë për të gjithë.

Petrit Vasili – Meqë iu referuam Komisionit të Ekonomisë, amendamenti bashkë me shpjegimet përkatëse është depozituar atje. Kështu që besoj se tashmë duhet të jenë njohur me të.

Fatmir Xhafaj – Meqenëse u kërkua kohë dhe ne kemi lënë 2-3 amendamente, e lemë edhe këtë pikë përpara votimit në tërësi.

Nga mënyra sesi është formuluar, në parim unë nuk mendoj se ka implikime detyruese për doganën. Gjithsesi do ta diskutojmë.

Neni 61 “Prova e origjinës”.

Petrit Vasili – Ne propozojmë që te neni 61 i Kodit të shtojmë një pikë 4 me këtë formulim: “Organet doganore detyrohen të pajisin me certifikatën euro 1, si certifikatë e origjinës së prodhimit shqiptar, të gjitha mallrat e gatshme që eksportohen nga subjektet e regjimit të përpunimit aktiv, të cilat operojnë në Shqipëri”. Të gjitha shpjegimet janë të përgatitura me shkrim dhe mund t’ua depozitojmë.

Genci Çeli – Përgjigjja për këtë pikë është ajo që thashë në fillim, që jo të gjitha mallrat mund të marrin certifikatë euro 1. Ka disa rregulla sesi merren, qoftë edhe për fasonistët. Varet nga lloji i mallit dhe nga aneksi i marrëveshjes përkatëse.

Petrit Vasili – Shpjegimet do t’i keni, por, meqenëse po bëjmë një shpjegim publik, më mirë ta bëjmë këtu që të jemi korrektë.

Certifikata euro 1 shërben si një lloj pasaporte garancie e produktit që ka marrë origjinë shqiptare dhe për t’ju lehtësuar në maksimum shitja në tregjet e BE-së dhe më gjerë. Besoj se ky është qëllimi themelor i procedurave doganore dhe i të gjithë biznesit që zhvillohet në Shqipëri. Duke qenë se nga praktika e deritanishme janë hasur vështirësi të rëndësishme procedurale për pajisjet me këtë lloj certifikate, ku produkti final, lëndët e para dhe ato ndihmëse i plotësojnë kriteret për t’u eksportuar në BE, atëherë nuk ka pse të krijohen pengesa artificiale të tjera për produktet e gatshme, që janë nën regjimin e përpunimit aktiv, por edhe më gjerë. Shpjegimi vjen për të ezauruar edhe përgjigjen, kështu që po e përsëris: ku produkti final, lëndët e para dhe ato ndihmëse plotësojnë kriteret për t’u eksportuar në BE.

Nga ana tjetër, është kërkesë e vazhdueshme rritja e të gjithë bizneseve partnere europiane, të cilat duan të investojnë në Shqipëri, që të certifikohen me euro 1, pasi plotësojnë të gjitha kriteret.

Së fundi, do t’u jepte një shtysë e madhe prodhuesve shqiptarë që me anë të certifikatës euro 1 të merituar, jo të dhuruar, të do të hyjnë në tregjet e reja, të cilat e kanë këtë kërkesë si një nga kërkesat bazë.

Pra, në fund të shpjegimeve të mia, thelbi i këtyre amendamenteve është një inspirim i ri pozitiv i një kodi, i cili ka fleksibilitetin, po të doni edhe dashamirësinë e

duhur që ky biznes të vuajë garën e tregut, por jo problematikat e zyrtarizimit të tij brenda vendit, të cilat, përveçse e asfiksojnë dhe ua bëjnë të pamundur përballimin e garës së kompeticionit jashtë Shqipërisë, nuk bëjnë asgjë tjetër.

Shpjegimet që dhashë janë edhe me shkrim dhe do t'i depozitoj në rast se nuk do ta gjeni të udhës që edhe këtë amendament ta hidhni në votim.

(Mungesë regjistrimi.)

Kjo është koha e fundit që marr për këto sqarime. Unë do të bëj një thirrje shumë dashamirëse, sepse një pjesë e amendamenteve janë depozituar në Komisionin e Ekonomisë. Rimarrja këtu është jo vetëm për të nderuar komisionin tonë, që edhe ai të japë mendimin e tij, por edhe për një arsye tjetër: nuk gjej ndonjë arsye për këtë hezitim kaq të madh, sepse atje janë depozituar me kohë. Vonohet, nuk shihen me gjakftohtësinë e duhur dhe mbeten rob të një procedure të vjetër, me të cilën ne duam të ndahemi.

Këto kërkojnë një shpejtësi të madhe dhe një pjesë e tyre afektojnë në mënyrë të veçantë biznesin fason, ku qeveria është shprehur me një paketë pozitive dhe integruese të tyre. Këtij ritmi të shprehjes së qeverisë për këtë sensibilitet duhet t'i përgjigjemi me shpejtësi shumë më të madhe në shqyrtimin e tyre dhe marrjen e një opinioni, ndonëse ne sigurisht rezervojmë të drejtën që t'i ndjekim dhe t'i mbështesim këto amendamente, të cilat në parim janë të shëndetshme deri në fund këtu dhe në sallën e parlamentit.

Elisa Spiropali – Grupi i punës që ka përgatitur Kodin Doganor ka zhvilluar takim me fasonët, unë nuk kam qenë e pranishme, por kolegët më thonë se çështja është fokusuar te fakti se i plotësojnë kriteret, por nga ana e administratës sonë procedurat paskan qenë të stërzgjatura. Ne po hetojmë që t'i thjeshtojmë procedurat.

(Zoti Xhafaj ndërhyr pa mikrofon.)

Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 62.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Konstatohet se në të gjithë Kodin Doganor ka disa nene, duke filluar nga nenet 18, 26, 29, 35, 39 etj, ku thuhet “aktet zbatuese”, që ne i rregulluam. Kam një sugjerim: në fakt, te këto nene “aktet nënligjore” kanë lidhje me një nen paraardhës. Pra, ka të bëjë me detyrimet që kanë Këshilli i Ministrave, ministria dhe Drejtoria e Doganave për të nxjerrë akte nënligjore. Është hera e parë që ne i gjejmë si nene më vetë. Ndërkohë që në të gjithë

praktikën e kodeve dhe të legjislacionit ne i kemi paragrafë brenda të njëjtit nen për të bërë lidhjen logjike dhe për të bërë ekonominë legjislative. Sugjerimi im është: a është e mundur që të gjitha këto nene të futen aty ku duhet dhe të mos dalin nen më vete, sepse do të kemi në ligj gati 70-80 nene ku thuhet “aktet nënligjore”, ndërkohë që është mirë që ato të jenë të paragrafi i fundit i nenit përkatës?

Faleminderit!

Ervina Domi – Sigurisht që mund të shtohet në çdo moment, por kërkojmë mirëkuptimin, sepse do të krijonte shumë probleme me enumeracionin e aktit tashmë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Nuk ka kuptimin e aktit nënligjor.

Vasilika Hysi – Kjo lidhet me nenin 61.

Fatmir Xhafaj – Ju doni ta kaloni te neni 61. Është çështje teknike.

Ervina Domi – Do të na lidhet shumë edhe me momentin e hyrjes në fuqi të këtyre akteve, sepse e kemi një nen të veçantë, ku evidentohet çdo dispozitë e Kodit për të cilën Këshilli i Ministrave do të detyrohet të nxirrte akte zbatuese, për këtë arsye janë grupuar më vete.

Fatmir Xhafaj – Kemi nenin 62 me vërejtjet që u bënë.

Neni 63.

Elisa Spiropali – Kemi rënë dakord. Është në rregull.

Fatmir Xhafaj – Miratohet neni 63.

Neni 64. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 65. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 66 “Metoda e vlerësimit doganor”. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 67 “Elementet e vlerës së transaksionit”. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 68 “Elementet që nuk përfshihen në vlerën doganore”. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 69 “Thjeshtësime”. Çfarë lidhje ka kjo fjala “thjeshtësime” me përmbajtjen?

Gjeni një titull tjetër.

Elisa Spiropali – Ne në administratën doganore i themi thjeshtimi i procedurave.

Kështu është edhe standard.

Lehtësimi është pak me ndryshe se thjeshtimi.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por nuk ka lidhje me termat e përdorur në brendësinë e nenit.

Në rregull, shikojeni një herë nenin 69, Erinda!

Neni 70 “Metodat dytësore për vlerësimin doganor”. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 71. A jeni dakord me sugjerimin e bërë? Dakord.

Miratohet.

Neni 72. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 73. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 74 “Borxhi doganor”. A jeni dakord?

Miratohet me vërejtjen që është bërë.

Neni 75. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 76. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 77. A jeni dakord me vërejtjen që është bërë në material?

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet me vërejtjen që është në tabelë.

Neni 78. A jeni dakord me vërejtjen që është bërë në material?

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet neni 78 me sugjerimet bëra.

Neni 79 “Debitorët solidarë”. Ndryshon titulli. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 80. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 81. A jeni dakord me sugjerimin e bërë në tabelë?

Miratohet.

Neni 82. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 83 sipas sugjerimit të bërë. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 84, me sugjerimet e bëra për pikat 5 dhe 6. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 85. Nuk ka vërejtje ose sugjerime. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 86. Nuk ka vërejtje ose sugjerime? A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 87. A jeni dakord me sugjerimin që është bërë?

Elisa Spiropali – Po, “në një informacion bankar”.

Fatmir Xhafaj – Miratohet neni 87.

Neni 88 “Zgjedhja e garancisë”. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 89 “Dorëzanësi”. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 90. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 91. A jeni dakord me sugjerimin e bërë, që është në tabelë?

Elisa Spiropali – Po, në rregull.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 92 “Garancia plotësuese ose zëvendësuese”.

Vasilika Hysi – Termi “garanci globale”?

Elisa Spiropali – Është term standard dhe është pjesë e direktivës së BE-së.

Ervina Domi – Kemi rënë dakord ta shtojmë edhe te përkufizimet. Me kërkesë të këshilltarëve, është dhënë përkufizimi i “garancisë globale” që te neni 6 te “Përkufizimet. Pra, është një garanci që nuk mbulon një operacion, por një grup operacionesh, për këtë arsye quhet globale.

Fatmir Xhafaj – Neni 93.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ermonela Felaj – Ne jemi për përdorimin e termit “garancia gjithëpërfshirëse”.

Le ta vlerësojnë ato nëse shkon ose jo me përkufizimin.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, shikojeni dhe flasim.

Neni 94. A jeni dakord me sugjerimin e bërë? Dakord.

Miratohet.

Neni 95. A jeni dakord me sugjerimin e bërë?

Elisa Spiropali – Po, fjala “vlerësohet”. Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 96 “Njoftimi i borxhit doganor”. A jeni dakord me sugjerimet që janë bërë?

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 97 “Parashkrimi i borxhit doganor”. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 98. Relatori thotë që nuk ka vërejtje dhe sugjerime. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 99 “Koha e kontabilizimit”, me ndryshimet e pasqyruara në tabelë. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 100. A jeni dakord me sugjerimin e bërë? Dakord.

Miratohet.

Neni 101. Nuk ka vërejtje ose sugjerime.

Miratohet.

Neni 102. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 103. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 104. A jeni dakord?

Elisa Spiropali – Kemi rënë dakord.

Fjala “periudhë” zëvendësohet me fjalën “afat”.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 105. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 106. A jeni dakord me sugjerimet? Dakord.

Miratohet.

Neni 107. Nuk ka vërejtje ose sugjerime.

Miratohet.

Neni 108. Dakord me sugjerimin e bërë që në fillim.

Miratohet.

Neni 109. A jeni dakord me ndryshimet? Dakord.

Miratohet.

Neni 110 “Shuma të paguara tepër detyrimit”. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 11. A jeni dakord me sugjerimin e bërë?

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 112. A jeni dakord me ndryshimet e bëra?

Elisa Spiropali – Jemi dakord me ndryshimet.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 113 “Kompensimi”. A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 114. A jeni dakord me sugjerimet e bëra në tabelë? Dakord.

Miratohet.

Neni 115.

Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – I rikthehem shqetësimit që ngrita te neni 15, meqenëse nga neni në nen shoh se diferenca midis rregullit të përgjithshëm që parashikohet dhe detyrimit për aktet nënligjore largohet shumë. Konkretisht, në nenin 115 ju merrni përsipër të rregulloni pikën 3 të nenit 109. Pra, shiko sesa larg kemi shkuar! Prandaj, do t’ju lutem të shikoni mundësinë nëse ky nen sistemohet pikërisht te neni 109! Çdo qytetar që është i detyruar të zbatojë Kodin Doganor, por edhe çdo punonjës dogane duhet ta dijë nenin në

tërësinë e tij. Pra, cili është rregulli dhe detyrimi, sepse është larguar shumë? Po shikoj se nga neni në nen këto akte nënligjore largohen nga dispozita e bazë e origjinës. Kjo mund të krijojë shumë probleme.

Fatmir Xhafaj – Këto janë me kre të ndryshme dhe ndoshta kanë bërë një përmbledhje në fund të kreut për të gjitha.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, do të pajtohesh me këtë që thoni ju nëse bëhet për të gjitha në fund të çdo kreu, por edhe te neni 115, edhe te neni 108 ne i referohemi ose nenit 101, ose nenit 109. Pra, nuk bëhet për të gjithë kreun, por bëhet për pika konkrete të një neni konkret. Do të ishte shumë më mirë që dispozita bazë dhe detyrimit të jenë bashkë. Të paktën kështu e kuptoj unë.

Ervina Domi – Edhe sipas rregullores, se ne atë rrugë kemi ndjekur, jo për të thënë që e ka rregullorja, por është lënë që aktet zbatuese të bëhen në fund të çdo seksioni. Pra, ne shohim te seksioni III “Rimbursimi dhe falja”, ku fillon neni 109, pasohet në fund të nenit 115 me “aktet zbatuese”, ku tregohet se çfarë do të bëhet me nenin 109. Pra, lë në diskrecionin e Këshillit të Ministrave rregullimin e disa elementeve të caktuara. Kjo është bërë për çdo seksion. Ky është parimi që është ndjekur. Për çdo seksion është përcaktuar grupi i dispozitave që kanë nevojë për akte zbatuese.

Fatmir Xhafaj – Ky është rregullimi. Kjo përshtypje m’u krijua edhe mua.

Zoti Manja.

Ulsi Manja – Kam një pyetje lidhur me këto që po diskutojmë. Ju thoni se dispozitat që parashikojnë aktet zbatuese ndjekin rregullin e seksionit, por a kanë lidhje me titullin në tërësi të gjitha dispozitat që parashikojnë akte zbatuese? Shoh që Kodi ka ndjekur ndarjen: titull, kre, seksion. Ju thoni se aktet zbatuese do të jenë pas çdo seksioni. A kanë lidhje me titullin aktet zbatuese? Pra, a mund të merren në sinkron me titullin për çdo seksion?

Faleminderit!

Ervina Domi – Patjetër që do të jenë në sinkron edhe me titullin. Do të vijnë në kronologji. Aktet zbatuese në total do të trajtojnë të gjitha dispozitat, duke filluar nga secili titull, nga secili kre apo seksion, do të definojnë në dispozitat zbatuese sipas përcaktimeve.

Ermonela Felaj – Unë mendoj se ne mund ta gjejmë gjuhën shumë më thjeshtë mbi bazën e arsytimit që ngriti zonja Hysi. Nëse bëhet fjalë për nxjerrjen e një akti nënligjor për një nen konkret, është mirë që fill pas atij neni të vini nenin ku parashikohet nxjerrja e aktit nënligjor dhe jo ta spostoni, se nuk ka asnjë kuptim për atë që e lexon dhe për atë që e zbaton Kodin. Ky duhet të jetë rregulli. Ne nuk po kërkojmë që kjo të bëhet detyrues kudo ku flitet për aktet nënligjore, por, aty ku është e mundur dhe është e qartë, ju mund ta bëni këtë riorganizim. Kjo është ideja e kësaj që sapo u tha.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, le ta shikojë këshilltarja me stafin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave se ku ka një përputhshmëri të tillë, për efekt të teknikës legislative, pavarësisht se unë do ta konsideroja të nevojshme që ato, kur janë për disa dispozita të një seksioni, të jenë në fund të seksionit, sepse kanë të njëjtën logjikë, të njëjtin arsyetim, të njëjtën fashë objekti, sipas kreut dhe seksionit përkatës. Gjithsesi, përpara se ta kalojmë në tërësi, të shohim nëse ka ndonjë gjë që duhet rregulluar nga kjo pikëpamje procedurale.

Vazhdojmë me nenin 115 duke e kaluar me këtë sugjerim.

Neni 116.

Elisa Spiropali – Jemi në rregull me ndryshimin e bërë.

116-ta u miratua.

Neni 117, “Zbatimi i penaliteteve”, jeni dakord?

Dakord.

Neni 118. Jeni dakord me sugjerimin që është bërë?

Dakord.

Neni 119. Jeni dakord me sugjerimin që është bërë?

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 120. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 121 nuk ka vërejtje dhe sugjerime.

Dakord.

Neni 122. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 123, me sugjerimin që është bërë që në fillim.

Miratohet.

Neni 124. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 125. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 126. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 127. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 128 “Transporti në rrethana të veçanta”. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 129, me sugjerimin që është bërë. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 130 “Paraqitja e mallrave në doganë”. Jeni dakord me sugjerimin?

Elisa Spiropali – Dakord me sugjerimin.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 131. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 132. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 133. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 134. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 135. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 136, me sugjerimin e bërë. Jeni dakord?

Elisa Spiropali – Dakord me sugjerimin.

Famir Xhafaj - Miratohet.

Neni 137. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 138, me sugjerimin që është në tabelë. Jeni dakord?

Elisa Spiropali – Dakord me sugjerimin.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 139. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 140. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 141 siç është thënë në fillim. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 142. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 143. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 144. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 145. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 146. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 147. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 148. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 149 nuk ka vërejtje. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 150. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 151. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 152 “Deklarata e thjeshtuar”. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 153 “Deklarata plotësuese”. Jeni dakord me sugjerimin?

Elisa Spiropali – Dakord me sugjerimin.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 154. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 155. Jeni dakord me sugjerimin?

Elisa Spiropali - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 156. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 157. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 158. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 159. Jeni dakord me sugjerimin?

Elisa Spiropali – Dakord me sugjerimin.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 160. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 161. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 162. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 163 ka një sugjerim. Jeni dakord?

Elisa Spiropali – Pika 1, paragrafi 2, dakord.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 164. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 165 “Hyrja në regjistrimet e deklaruesit”. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 166. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 167. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 168. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 169. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 170. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 171. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 172. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 173. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 174. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 175 “Çlirimi”. A mund t’i gjeni një titull tjetër? Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 176. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 177 në logjikën e akteve sipas fundseksionit. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 178 “Shkatërrimi i mallrave”. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 179. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 180. Jeni dakord?

Vasilika Hysi – Në nenin 180 nuk e di nëse fjalën “braktisje mund ta zëvendësojmë për ta riformuluar nga pikëpamja e teknikës së të shkruarit. Nuk del e qartë çfarë do të thotë “mallrat joshqiptare dhe mallrat e vendosura në origjinë të përdorimit të veçantë përfundimtar mund të braktisen në favor të shtetit”. Si mund të braktisen në favor të shtetit? “Braktisja në favor të shtetit” nuk ka sens dhe togfjalëshi “me miratim paraprak të autoriteteve doganore” të vendoset në një vend më të përshtatshëm.

Ervina Domi – Mund ta shohim në kuadër të riformulimit. Ideja është që ka mallra që braktisen nga ai që mban qëndrimin. Pra nuk vjen në doganë, nuk i merr, i lë aty dhe automatikisht shkojnë në favor të shtetit. Kur kalojnë një periudhë të caktuar.

Fatmir Xhafaj – Kjo është tjetër gjë, sepse kështu si e keni konceptin i thoni: unë po i braktis këto që t’i përfitojë shteti.

Ervina Domi – E riformulojmë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Frroku e ka fjalën.

Mark Frroku – A ka një afat të caktuar për braktisjen?

Elisa Spiropali - por edhe atëherë kur me shkrim ai deklaron se i braktis. Janë të gjitha rastet. Prandaj është parashikuar kështu. Në të dyja rastet është në favor të shtetit.

Mark Frroku – Kur nuk e bën me shkrim, ka një afat?

Fatmir Xhafaj – Në nenin 181 thuhet: “Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat procedurale”.

Pika “c”, që ne do ta ndryshojmë, “braktisen në favor të shtetit sipas përcaktimeve të nenit 180”. E kemi të përcaktuar te një nen më poshtë dhe e përcakton me vendim të Këshillit të Ministrave.

Jeni dakord me nenin 180 me sugjerimin e zonjës Hysi?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Elisa Spiropali – Edhe në kodin aktual është “braktisja” dhe ne e kemi ruajtur termin se është i konsoliduar. Një prej regjimeve është braktisja, kur ai nuk vjen ta deklarojë.

Miratohet.

Neni 181 me sugjerimin që ka lidhje me sugjerimin e 180-s nga zonja Hysi. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 182. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 183 “Masat e politikës tregtare”. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 184 me sugjerimet e bëra. Jeni dakord?

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 185 “Fusha e zbatimit dhe efekti”. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 186. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 187. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 188. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 189. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 190. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 191. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 192 “Autorizimi”. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 193. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 194. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 195. Jeni dakord?

Elisa Spiropali – Dakord me sugjerimet.

Fatmir Xhafaj – Miratohet me sugjerimet si janë parashtruar në tabelën përkatëse.

Neni 196. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 197. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 198. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 199. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 200. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 201. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 202. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 203. Jeni dakord?

Elisa Spiropali – Jemi dakord me sugjerimin.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 204. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 205. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 202. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 206. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 207. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 208. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 209. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 210. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 211. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 212. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 213. Jeni dakord, zonja Spiropali?

Elisa Spiropali – Jemi dakord me sugjerimet.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 214. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 215. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 216 “Përcaktimi i zonave të lira”. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 217. Jeni dakord?

Elisa Spiropali – Jemi dakord me sugjerimet.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 218. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 219. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 220. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 221. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 222. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 223. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 224. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 224. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 225. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 226. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 227. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 228. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 229. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 230. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 231. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 232. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 233. Jeni dakord?

Elisa Spiropali – Jemi dakord me sugjerimet.

Fatmir Xhafaj – Miratohet me sugjerimin që është paraqitur dhe për të cilin është rënë dakord me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Neni 234. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 235. Jeni dakord?

Elisa Spiropali – Jemi dakord me sugjerimet.

Fatmir Xhafaj – Miratohet me reflektimin përkatës.

Neni 236 “Depozitimi i një deklarate përparanisjeje”. Jeni dakord?

Vasilika Hysi – Titulli i kreut mendoj të shihet se formalitetet përpara daljes së mallrave duhet të jenë dokumentacioni ose procedurat, se fjala “formalitet” sikur ka konotacion negativ, formal. Mendoj se janë procedurat, jo formalitetet.

Ervina Domi – Te përkufizimet është përcaktuar se cilat janë formalitetet doganore dhe nuk është një procedurë e caktuar, është një tërësi procedurash dhe veprimesh, që ndërthuren me njëra-tjetrën. Është më shumë se aq dhe kemi rënë dakord që te përkufizime për ta lënë fjalën “formalitet”, duke përkufizuar nga se përbëhet. Kërkoj mirëkuptim për ta mbajtur, sepse tashmë prej shumë kohësh është edhe pjesë e fjalorit doganor dhe pjesë e rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Elisa Spiropali – Unë e kuptoj shqetësimin tuaj, por edhe në direktivën e BE-së ndryshon “procedura” nga “formaliteti”. Janë dy koncepte të ndryshme dhe ne i kemi ruajtur, sepse janë edhe në kodin e vjetër, janë të konsoliduara dhe pjesë e zhargonit të doganës. Nuk janë procedura, por një tërësi veprimesh. Pra, tërësia e këtyre veprimeve përbën atë që quhet formalitet. Kërkojmë mirëkuptimin për ta mbajtur.

Fatmir Xhafaj – Dakord, miratohet.

Neni 237 “Analiza e riskut”. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 238. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 239. Jeni dakord?

Elisa Spiropali – Jemi dakord me sugjerimet.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Miratohet me ato, sipas tabelës.

Neni 240? Dakord.

Neni 241? Dakord.

Vazhdojmë.

Neni 242? Dakord!

Neni 243? Dakord!

Neni 244? Dakord!

Armando Subashi – Ka një sugjerim.

Fatmir Xhafaj – Po. Neni 244?

Armando Subashi – Që lidhet edhe me nenin 247.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Spiropali.

Elisa Spiropali – Zëvendësohet me “anulohet”.

Fatmir Xhafaj – Dakord!

(Diskutime pa mikrofon)

Te neni 244? Në rregull! Dakord! Po, dakord! Neni 244 me sugjerimin e bërë.

Neni 245? Dakord!

Neni 246: “Depozitimi, njoftimi i ri i eksportit”. Dakord!

Neni 247?

Armando Subashi – Është i njëjti sugjerim...

Fatmir Xhafaj – Po, neni 247 me atë të 245-s. Dakord!

Elisa Spiropali – Dakord!

Fatmir Xhafaj – Po, faleminderit!

Neni 248. Dakord!

Neni 249. Dakord!

Neni 250: “Klasifikimi i shkeljeve e kundërvajtjeve administrative, kontrabanda”.

(Diskutime pa mikrofon)

Po.

Vasilika Hysi – Unë kam një shqetësim, në fakt, që e kemi konstatuar prej kohësh, lidhur me raportin midis Kodit Doganor dhe Kodit Penal. Ka të paktën disa vite rresht që, edhe në fushën e teorisë së të drejtës penale, pjesës së posaçme, bëhet një diskutim lidhur me përkufizimin e kontrabandës dhe që pjesa më e madhe e kundërvajtjeve administrative janë të parashikuara edhe në Kodin Penal.

Në kodin aktual, të vjetrin, ju e keni për aq kohë sa nuk bie ndesh me këtë ligj, dhe bëni përkufizimin e kundërvajtjes administrative. Në fakt, tani po flas, për shkak të njohjes së mirë që kam nga ana e teorisë në këtë fushë, shoh se shpeshherë, nga gjithë praktika, ju keni shumë pak çështje penale të hetuara e të gjykuara për kontrabandë. Madje, do të thosha se për nenin 171, 172, që janë krime të rënda, nenin 173, s’keni fare;

tek – tuk ndonjë rast keni. Me sa duket zbatohet më shumë Kodi Doganor në vend të Kodit Penal.

Ka ardhur koha për të parë një raport më të drejtë midis kontrabandës si kundërvajtje administrative dhe kundërvajtjes si vepër penale, sepse i lihet abuzivitet praktikës, për të mos e goditur sa dhe si duhet kontrabandën, përndryshe hajde të përmirësojmë edhe Kodin Penal dhe mos ta lëmë atë seksion nga 171 te 179 “a”-ja, pothuaj të pazbatuar ose të zbatuar për vetëm dy vepra penale.

Unë këtë e kam shqetësim dhe nuk e di sa e keni reflektuar në këtë kre këtë përplasje që kanë dispozitat e Kodit Doganor, që janë shumë më të ashpra se Kodi Penal. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, një koment. Ju lutem!

Elisa Spiropali – Është jashtëzakonisht shumë i drejtë shqetësimi që ngrihet. Është e vërtetë që ka pasur edhe problematika në përplasjen e klasifikimit të shkeljeve. Jemi përpjekur në maksimum që të përmirësojmë këtë përplasje. Për hartimin e pjesës së shkeljeve ne jemi bazuar në një draft-direktivë të BE-së, por edhe pse ishte draft-direktivë, jemi përpjekur që ato shkelje që vetë direktiva i kishte konsideruar kundërvajtje, nëse sipas Kodit tonë Penal përbënin kontrabandë, atëherë i kemi transferuar te klasifikimet e kontrabandës. Jemi përpjekur, shpresojmë që t’ia kemi arritur, por është pasur në konsideratë.

Fatmir Xhafaj – Po. ka tjetër?

Ermonela Felaj – Një sugjerim kam prapë. Po shoh pikën 3 të nenit 250 të projektit dhe shoh një përpjekje për të dhënë përkufizim për kontrabandën. Mendoj se në Kodin Penal ne e kemi të dhënë shprehimisht se çfarë konsiderohet kontrabandë dhe nuk mundet që në një ligj, që nuk e ka për objekt të fushës së vet dënimit penal, vënien para përgjegjësisë penale, të bëhen parashikime të kësaj natyre. Për kundërvajtjen administrative unë jam dakord, nuk kam ndonjë problem, po për kontrabandën... Dhe këtu te ndarja: “shkeljet doganore janë kundërvajtjet legjislative dhe kontrabanda”.

Fatmir Xhafaj – Por, a ka përputhshmëri midis dy koncepteve? Ka ndryshime?

Ermonela Felaj – Nuk është e njëjta gjë.

Fatmir Xhafaj – Nuk është e njëjta gjë?

Ermonela Felaj – Jo, nuk është e njëjta gjë.

Fatmir Xhafaj – Me konceptin që ka kodi...?

Ermonela Felaj – Nuk është e njëjta gjë.

Fatmir Xhafaj – Këtu ndryshon çështja.

Po?

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem! Po?

Elisa Spiropali – Ne e kemi marrë direktivën siç është direktiva e Bashkimit European...

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Elisa Spiropali – ...Union Custom Code dhe e kemi vënë duke qenë se është objekt i punës tonë edhe kundërvajtja, edhe kontrabanda. Në qoftë se ka nevojë dhe ju mendoni se duhet parë, ne jemi të gatshëm të ulemi e ta rishikojmë.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, ta lëmë 250-ën, ju lutem?

Elisa Spiropali – Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Zonja Felaj, atëherë merreni e shikojeni Kodin Penal. Elida, e mbajte shënim, të lutem, që të ma kujtosh? 250-ën, të lutem! Je lodhur, Elida, por durim, se Kodi Doganor nuk është i lehtë.

Neni 250? Në rregull.

Neni 251 me sugjerimin e bërë? Po e kemi ndryshuar pra, lexove tabelën.

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord!

Neni 251?

Neni 252 me sugjerimin e bërë? Dakord.

Neni 253? Dakord.

Neni 254?

Elisa Spiropali – Në rregull me ndryshimet.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit. Dakord.

Neni 255? Dakord.

Neni 256? Si ta kuptoj unë këtë? “Gabime të autoriteteve doganore”. E kemi dhënë konceptin çfarë quajmë gabim të autoritetit doganor, sepse ju thoni se nxitja apo ndihma dhe pafajësia... është kundërvajtje”. Kur e bëjnë këta.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, jo.

Elisa Spiropali – Ka dispozita më përpara, që lidhen me gabimet e autoriteteve doganore. Për shembull, autoritetet doganore i kanë mbajtur detyrime më shumë se ç'i takonte të mbanin. Pra, flitet për raste kur në sistemin elektronik është aplikuar gabim një rregull i caktuar, që lidhet me një transaksion të caktuar ose procedurë të caktuar doganore. Në këto raste nëse gabimi, pasaktësia në një dokumentacion apo në një procedurë, ka ardhur për shkak të gabimit të autoritetit, nuk mund të penalizohet operatori.

Fatmir Xhafaj – Po. Dakord. Urdhëro? Dakord.

Neni 256?

Elisa Spiropali – Në rregull me ndryshimet.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 257? Dakord.

Neni 258? Dakord.

Neni 259? Dakord.

Neni 260? Dakord.

Neni 261? Dakord.

Neni 262? Dakord.

Neni 264? Dakord.

Neni 265? Dakord.

Neni 266: “Kontrabanda, rastet e kontrabandës”. Dakord.

Neni 267: “Raste të tjera kontrabande”. Dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

E para, një herë, nuk është në vlerësimin e doganës, por është një vlerësim i Kodit Doganor. Kodi do ta japë konceptin. Pastaj për sa kohë që ajo përbën një penalitet, do t'u nënshtrohet dispozitave të Kodit Penal. Në qoftë se ka këtu një përplasje midis...

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull. Dakord. Kur të shikoni konceptin aty, e shikoni edhe këtë dhe flasim. A ka mundësi, të lutem? Do të bëjmë pyetje këtu?

(Diskutime pa mikrofon)

Po unë them: në qoftë se do ta shikoni përputhshmërinë me...

(Diskutime pa mikrofon)

Po pra, dakord, dakord!

Ermonela Felaj – E shoh se teprohet me këtë pjesë dhe do të bëjmë përplasje; dhe ky është ligj i cilësuar, edhe ato janë ligje të cilësuar. Eja tani e sqaroje në praktikë se cili ligj do të zbatohet.

“E drejta e arrestimit dhe e ndalimit”. “Organet e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë e të ndalojnë... Sipas nenit 251, në kodin doganor...” Nuk ka lidhje fare kjo pjesë. Nuk mundesh dot të parashikosh në Kodin Doganor gjëra të tilla.

Edhe ai merak im te kontrabanda është se, po i dhamë në mënyrë shteruese ne se cilat janë rastet e kontrabandës, do të dalë një rast në praktikë që nuk e ka këtu lista dhe atëherë nuk është kontrabandë. Më kupton? E kam këtë merak, sepse fusha është kaq e gjerë, janë kaq të panumërta mënyrat se si mund të bëhet kontrabandë, sa që nuk mund të marrësh përsipër një gjë të tillë ti dhe t’i rendisësh se këto janë rastet përbëjnë kontrabandë.

Vërejtja tjetër që kam, se po shoh se ka disa përcaktime, në fakt, është se në cilën teori të së drejtës mësohen. “Kundërvajtje me neglizhencë”, “Kundërvajtje me qëllim”. Nuk i ka këto teoria. Nuk i gjen as në teorinë e së drejtës administrative, as një teorinë e së drejtës penale.

Nuk e di se si do të kuptohet ky kod, në qoftë se futen nocione të tilla të padëgjuaara më parë dhe të pasqaruara. Ne jemi juristë dhe ndjehemi keq kur i shohim të shkruara kështu. Për këtë pjesë unë do të doja të kishim edhe mirëkuptimin e doganës, që t’i korrigjojmë.

E diskutuam edhe që në fillim të kodit doganor, për pjesën se si bëhej referimi në prokurori, i materialeve të cilat përmbajnë të dhëna për kryerjen e veprave penale.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Dakord. Ne e kalojmë. Dhe për nenet që do të keni... Po.

Elisa Spiropali – Në çdo kod doganor përcaktohet kontrabanda dhe rastet e kontrabandës, sepse administrata doganore ka të drejtë për të ndaluar e për të arrestuar.

Fatmir Xhafaj – Për të arrestuar jo.

Elisa Spiropali – Shumë nga hetuesit e doganës janë oficerë të policisë gjyqësore dhe referojnë rastet. Kështu që i duhet specifikimi për të referuar. Edhe kodi i vjetër e ka, edhe i riu, edhe çdo kod evropian. Çdo kod evropian e ka kontrabandën në kod doganor, nuk mund ta heqë.

(Ndërprerje incizimi)

...armë, janë antikontrabandë, kanë pranga...

(Ndërprerje incizimi)

Vasilika Hysi – Te neni 270, në radhë të parë them se ç’ quhet dënim penal, e ka Kodi Penal, por njëkohësisht nuk mund të përdorim fjalët: “ndëshkim administrativ”. Do të themi: “masa administrative”, ose “sanksione administrative”.

Pra, shkelësi, përveç sanksioneve administrative për kryerjen e kontrabandës, një nga format e parashikuara nga ky kod i nënshtrohet ndjekjes penale, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale. Ndjekja rregullohet nga Kodi i Procedurës Penale.

Po përsëri kam shqetësim. E kam për dy juristet. Si do të rregullohet raporti midis kontrabandës sipas Kodit Penal dhe kontrabandës me kodin, sepse është shumë abuzive? Një punonjës i doganës mund të abuzojë duke vënë një gjobë dhe e shmang nga përgjegjësia penale, që është dhjetë vjet burg. Nuk është njëloj dhjetë vjet burg me një gjobë.

Fatmir Xhafaj – E lamë që ta rishikojmë atë kur të shohim konceptin, nuk e kam parasysh se te cili nen, për të parë përputhshmërinë me kodin...

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord. Atje ku e lamë, aty do të shikojmë edhe këtë.

Neni 271. Në rregull. Dakord.

(Ndërpreje e shkurtër incizimi)

Elisa Spiropali – Në rregull me sugjerimet.

Fatmir Xhafaj – Neni 272? Dakord.

Neni 273? Dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Epo relatori nga Fieri është.

Neni 274? Dakord.

Neni 275? Dakord.

Neni 276? Dakord.

Neni 277? Dakord.

Elisa Spiropali – Në rregull me sugjerimet.

Fatmir Xhafaj – Po, me sugjerimin që është bërë,

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord?

Elisa Spiropali – Po, dakord.

Fatmir Xhafaj – Po, faleminderit!

Neni 278? Dakord.

Elisa Spiropali – Në rregull me sugjerimin.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 279?

Elisa Spiropali – Po, në rregull.

Fatmir Xhafaj – Miratohet edhe më sugjerimin e bërë.

Neni 280? Dakord.

Neni 281? Dakord.

Neni 282?

Elisa Spiropali – Kemi një përgjigje për këtë.

Fatmir Xhafaj – Po.

Ervina Domi – Atëherë, te neni 282 është sugjeruar nga këshilltarët që të jenë dy opsione. Pra, për të paraqitur një ankesë, operatori ekonomik ose duhet të parapaguajë gjithë shumën principale të detyrimit doganor dhe të penaliteteve, ose t'i garantojë ato. Tërë kjo procedurë është përdorur edhe më poshtë. Aktualisht ne kemi parashikuar, që bazuar edhe në nenin 138 të Kodit të Procedurës Administrative, të mos pezullohet pagesa e shumës së detyrimeve doganore. Pra, të paguhet shuma dhe të garantohet pjesa tjetër e sanksioneve.

Kjo është një prej lehtësive, aktualisht në Kodin Doganor ishte parashikuar parapagim 40 % të gjobës. Kjo dispozitë ka qenë objekt edhe i rishikimit në Gjykatën Kushtetuese, ku diskutohej të verifikohet nëse është apo jo antikushtetues detyrimi për të parapaguar 40 % dhe më pas edhe 60 % për të shkuar në gjykatë. Është rënë dakord që

nuk është antikushtetuese edhe parapagesa e 40-përqindëshit. Megjithatë, pavarësisht nga kjo, ne e kemi hequr si detyrim parapagimin, duke vendosur garantimin e penaliteteve.

Do të kërkonim mirëkuptimin për lënien e kësaj dispozite, sepse është një rast shumë i mirë, ku ne kemi mundësi të vjelim borxhin doganor. Nëse do të shkonim drejt garantimit edhe të penalitetit, në radhë të parë do të binim ndesh me Kodin e Procedurës Administrative, por nga ana tjetër, do të na krijohej një borxh shumë i madh, që do të ishte vërtet shumë problem për administratën doganore.

Fatmir Xhafaj – Po, relatori?

Armando Subashi – Do ta shohim edhe këtë.

Fatmir Xhafaj – Edhe këtë, kërkon kohë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një minutë, jemi te neni 282.

Ok, ngelet neni 282, Erida, me relatorin.

Neni 283? Dakord.

Neni 284? Dakord.

Neni 285? Dakord.

Neni 286? Dakord.

Neni 287? Dakord.

Neni 288? Dakord.

Neni 289? Dakord.

Neni 290? Dakord

Neni 291? Dakord.

Neni 292? Dakord.

Kanë ngelur, mos gaboj, rreth 8 nene, që nuk kanë kaluar.

Zonja Caka, më thatë për nenet 227, 228 dhe 229. Kërkoj ndjesë, sepse zonja Caka...

Silva Caka – Edhe unë kërkoj ndjesë praktikisht.

Atëherë, në nenin 227 ne propozojmë që të shtohet një pikë e numërtuar 8, me këtë përmbajtje: “Përfshihen nga pikat e mësipërme të këtij neni mbetjet që rezultojnë nga procesi teknologjik i përpunimit të lëndëve të para, të përdorura nga industritë e përpunimit aktiv, të cilat depozitohen ose shkatërrohen në një vend të posaçëm të

përcaktuar nga organet e qeverisjes vendore, kur këto mbetje nuk mund të përdoren në interesin publik”.

Në rast se keni nevojë, mund të lexoj edhe argumentet ose relacionin shpjegues për këtë amendim.

Fatmir Xhafaj – Jo, nuk ka gjë, vetëm për efekt të procesverbalit, se do t’i japim kohë t’i shohim bashkë me ...

Silva Caka – Do të dëshironim që t’i depozitonim të gjitha këto...

Fatmir Xhafaj – Të lutem, vetëm për efekt të procesverbalit. Neni 228?

Silva Caka – Në nenin 228 amendohet shtimi i dy pikave të tjera, të numëtuara 3 dhe 4, respektivisht me këtë kontekst: pika 3: “Autoritetet doganore për mallrat që janë në regjimin e përpunimit aktiv, që përdorin si kriter referues parësor sasinë e produktit final të porositur, siç rezulton nga dokumentacioni doganor”.

Fatmir Xhafaj – Neni 228 është për koeficientin e shfrytëzimit. Aty e bëni shtesën?

Silva Caka – Pika 3, në nenin 225.

Fatmir Xhafaj – E shtoni?

Silva Caka – Po, e shtojmë.

Fatmir Xhafaj – Mirë.

Silva Caka – Ka të bëjë me kriterin referues ...

Fatmir Xhafaj – Neni 229?

Silva Caka - Jo, më fal, në nenin 228 kemi edhe pikën 4: “ Vetëm në rastet kur sasia e produktit final të porositur është në mënyrë të konsiderueshme jashtë marzheve të koeficienteve të aplikueshëm, gabimi jo më shumë se 5 %, procedojmë me verifikim, dhe nëse ekzistojnë kushtet, me vendosjen e sanksioneve”.

Ka nevojë për argumente?

Fatmir Xhafaj – Neni 229?

Silva Caka – Në nenin 229, po ashtu, shtojmë dy pika të numëtuara 4 dhe 5, me këto kontekste: pika 4: “Materialet e importuara në regjimin e përpunimit aktiv, pavarësisht origjinës së tyre, përjashtohen nga detyrimet financiare dhe doganore, sikurse gjithë pjesa tjetër e materialeve të përpunimit aktiv”.

Dhe pika 5: “Makineritë, pajisjet dhe pjesët e këmbimit të importuara, që janë drejtpërdrejt të lidhura me procesin e prodhimit në regjimin e përpunimit aktiv, pavarësisht origjinës së tyre, përjashtohen nga detyrimet financiare dhe doganore, sikurse gjithë pjesa tjetër e materialeve të përpunimit aktiv”.

Fatmir Xhafaj – Ok. Faleminderit!

Silva Caka – Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Atëherë, kemi tri ndërhyrje tani të zonjës Caka për nenin 227, 228 dhe 229, që mbeten për t’u diskutuar; kemi dy ndërhyrjet e zotit Vasili për nenet 60 dhe 61, mos gaboj; kemi nenin 13, që e kemi lënë të hapur; kemi pjesën që lidhet me kontrabandën, ku do të dëshiroja edhe kontributin e zotit Muçmataj, zonjës Felaj dhe zotit Manja, janë 3 ish-prokurorë këtu së bashku me relatorin, pra kemi gjithë kreun për të parë.

Keni gjë tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, do t’i shikojmë këto nene që kanë ngelur, propozimet që u bënë, rezervat që u shfaqën nga kolegët deputetë, sidomos lidhur me kapitullin e kontrabandës, bashkë me nenin 13. Para se t’i kalojmë në tërësi, do t’u kërkoja ekspertëve të drejtorisë së Përgjithshme të Doganave që të jenë në kontakt me këshilltarët dhe vetë drejtuesit e doganave, që të kemi mundësi të arrijmë në disa definicione të qarta, pa cenuar kuadrin për të bërë përputhshmërinë me kuadrin ligjor, duke qenë se ka një problem, jemi në kushtet që janë ligje, të cilat miratohen me të njëjtën shumicë dhe mund të krijojnë konflikte ndërmjet dy ligjeve dhe do të ketë probleme në zbatim, por nga ana tjetër, askush nuk duhet të pretendojë se koncepti i kontrabandës dhe trajtimi i saj nuk do të duhet të jetë në Kodin Doganor, kjo nuk është e drejtë. Këtu duhet të jetë, duhet të jetë e qartë, duhet sqaruar mirë. Në qoftë se ka një gjë që krijon konflikt, jam dakord ta shikojmë.

E mbyllim kështu, atëherë? Para votimit në tërësi, do të shikojmë edhe këto dispozita, por brenda kësaj jave duhet mbyllur, në mënyrë që të bëhet gati për t’u kaluar pastaj në Komisionin e Ekonomisë dhe në seancë.

Jeni dakord? Dakord.

Faleminderit, të gjithë kolegëve!

Faleminderit, zonja drejtoreshë dhe ekipit që ju shoqëron!

Faleminderit edhe medias!

Nesër në orën 09:30 është mbledhja e komisionit, ku pika e parë është projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, dhe pika e 2 projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”. Këto janë për mbledhjen e paradites, ndërsa për mbledhjen e pasdites do t’ju njoftojmë nesër.

Faleminderit!

Nesër mblidhemi në orën 09:30, se mund ta kalojmë paradite edhe atë.

Faleminderit!

Natën e mirë!